



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në
"Klarnetë dhe Mësuesi"

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti i Arteve"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc. Dr. Astrit Mustafa

2. Dr. Matilda Likaj

Maj-2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Arteve”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Interpretimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Masteri i Arteve në ‘Klarinetë dhe Mësuesi’
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 234, datë 23.03.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër Nr.821, datë 26.12.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 142, datë 19.09.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim Nr. 17, datë 24.03.2022 “Për Akreditimin Periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i Arteve”
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë i Studimit ‘ Master i Arteve ‘Klarinetë dhe Mësuesi’
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ETCS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE/3 PAK (2021-2022)
18	Numri i studentëve:	2019-2020 4 studentë 2020-2021 6 studentë 2021-2022 6 studentë
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi i Studimit të nivelit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi' ofrohet nga Departamenti i Interpretimit, në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve. Programi Master i Arteve është miratuar për hapje e tij me dokumentin e licencës UMSAR Nr. 821, datë 26/12/2018, me urdhër nga Master i Arteve të bukura në 'Klarinetë', në riorganizim në Mastër i Arteve në 'Klarinetë dhe Mësuesi', sipas Ligjit të Arsimit të Lartë nr.80/2015. Emërtimi i diplomës është Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi", në sistemin 2-vjeçar me kohë të plotë", me Urdhër nga MASR, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme, Nr.142, datë 19/09/2018. Programi është në përputhje të plotë me strategjinë dhe politikën e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë të duhura akademike që i formojnë ata si profesionistë në profilin e mësuesisë së instrumentit Klarinetë.

Kurrikula e programit është e strukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në 120 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në dy vite akademike. Ai realizohet në gjuhën shqipe.

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit, kanë hapur dhe zhvilluar programin duke respektuar kërkesat e tregut të punës dhe përditësimeve periodike, në përputhje të plotë me ligjin e arsimit të lartë. Programi studimor i ciklit të dytë, Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi', ndjek udhëzimet e realizuara nga Ministria e Arsimit si dhe ngjashmërinë e kurrikulave me standartet europiane.

Në rregulloren e këtij programi studimi përcaktohen qartë qëllimi dhe objektivat e programit: 'Qëllimi kryesor i programit të studimit Master i Arteve në 'Klarinetë dhe Mësuesi', Nëpërmejt aktiviteteve formuese, teorike dhe praktike, është të plotësojë nevojat e tregut arsimor/artistik/kulturor shqiptar me:

- Klarinetistë të kualifikuar për të performuar të gjitha gjinitë e muzikës si solistë, pjestarë të ansambleve si dhe pjesëtar të orkestrave simfonike dhe frymore apo baund-eve të muzikës moderne;
- Mësues/instrukturë të kurrikulave artistike për arsimin parauniversitar;
- Pedagogë për lëndët Klarinetë, Muzikë Dhome, Deshifrazh dhe Vështirësi Orkestrale pranë FM të UART;
- Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore.

Në qëllimin dhe objektivat strategjike të programit synohet edhe “përputhje optimale e dijeve akademike në fushën e interpretimit të instrumentave dhe mesuesisë, me aftësitë e kërkuara në tregun e punës dhe mundësinë e punësimit në institucione të rëndësishme të vendit tonë”.

Departamenti i Interpretimit ka nënshkruar marrëveshje me institucione të shumta për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale, edhe për realizimin e aktiviteteve artistike.


Programi i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm për herë të parë.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tcl:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al



 4

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) e nisi punën që në dhjetor të vitit 2022, në komunikim të përbashkët për përcaktimin e detyrave kryesore që do të realizoheshin gjatë procesit të vlerësimit. Në bashkërendim midis dy ekspertëve të jashtëm të vlerësimit dhe stafit të ASCAL u përcaktuan edhe datat e vizitave. Vizitat u realizuan dy ditë konkretisht me datat 6 dhe 7 dhjetor 2022.


GVJ u njoh me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në proces akreditimi përmes platformës dhe kredencialet që secili nga vlerësuesit e jashtëm ka në të poseduara prej ASCAL.

Gjatë dy ditëve të takimeve Grupi i vlerësimit të Jashtëm i përbërë nga Prof.Asoc. Astrit Mustafa dhe Dr.Matilda Likaj zhvilluan takime me Dekanin e Fakultetit të Muzikës, me Përgjegjësën e Departamentit të Interpretimit , Shefin e Sektorit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin e programit në proces akreditimi, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Karrierës dhe Alumni , Sekretarinë mësimore ,studentët. Në ditën e dytë u vizituan edhe ambientet e UART, auditoret,salla e digjitalizuar si dhe biblioteka dhe salla e ndëgjimit e pajisur me kompjutera. Për shkak të punimeve të restaurimit të hapësirave, në përgjithësi, nuk ishte e mundur të vizitohen sallat e koncerteve për arsey se ishte në proces restaurimi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), gjatë takimeve me grupet e caktuara në agjendë, u fokusua në bashkëbisedime konkrete për tema të caktuara si mekanizmi dhe fuqizimi i Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, procesimin e pyetësorëve, për aktivitetet koncertale të stafit dhe studentëve, për projektet ndërkombëtare dhe marrëveshjet bilaterale, për planin mësimor, kualifikimin e stafit, takimet me studentët etj.

Gjatë gjithë këtij procesi vlerësimi ka pasur një bashkëpunim shumë korrekt dhe bashkëpunues midis grupit të vlerësimit të jashtëm dhe stafit të UART.

Koordinatorë teknike e përcaktuar nga ASCAL, shumë bashkëpunues me GVJ-në në vlerësimin e këtij programi ka qenë Msc. Endra Velaj.



MEMO

Përgjigjet mbi Draft RVJ e Programit të Studimit Master i Arteve në "Klarnetë dhe Mësuesi"

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft-Raportin e programit të studimit Master i Arteve në 'Klarnetë dhe Mësuesi' vijon përgjigjen si më poshtë:

Nr.	Fusha	Standardi	Kriteri	Gjetja e GVJ	Përgjigjet e GVB	Përgjigja Përfundimtare e GVJ
1	III	III.3	Konkluzione	GVJ vlereson se institucioni përdor forma dhe procedura të vlefshme vlerësimi duke garantuar një vlerësim objektiv dhe në kohë nepernjët platformes Piagora dhe performances para publikut për lëndët artistike, por duhet të fillojë edhe kontrollin me sistemin elektronik dhe antiplagjiaturë të provimeve.	GVB duke vlerësuar gjetjen dhe rekomandimin e GVJ, sqaron se. Per vetë specifikën e programit të studimit Master i Arteve në Klarnetë dhe Mësuesi, i cili në lëndët me interpretim muzikor në kohë reale i realizon provimet me lojë live, pema komisioni të provimit apo diplomës, me prezencë publike, (pra, jo me detyrë të mbylltë) pammundësohet objektivisht dularia e kopjes apo e plagjiatures në provime dhe detyra. Në lidhje me punimin teorik të tezës së diplomës, duhet nënvizuar fakti që ai është një material analize i formës muzikore, specifilave të kompozitorit, idesë kompozicionale dhe elementëve stilistikë e estetikë, mbi veprën e përzgjedhur për t'u interpretuar live gjatë provimit të diplomës, i cili zëbërthen dhe ndërton logjikën dhe etapat interpretative në tërë kohëzgjatjen e saj. Per sa më lart, GVB do të sugjerojë përmes Departamentit të Interpretimit dhe Dekanatis të FM që Universiteti i Arteve të mundësojë një platformë antiplagjiaturë për verifikimin e punimeve teorike apo diplomave për t'u përdorur sipas nevojave që mund të dalin nga Departamentet e ndryshme të vetë	GVJ shqyrton dhe analizon përgjigjen e GVB-së, dhe e vlerëson si të pranueshme, duke ndryshuar vlerësimin!


Dr. Mathias Fries




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve/ Programi i Nivelit të Dytë në Klarinetë dhe Mësuesi

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Unversiteti i Arteve, i cili gezon prej datës 10/03/2021, me vendim nr.145, statusin e veçantë, ofron programin e studimit Master i Arteve në ‘Klarinetë dhe Mësuesi’, i cili paraqet një qartësi nëpërmjet profilit të universitetit (shiko përshkrimin e vizionit të universitetit) në mosrënien ndesh të interesave kombëtare si dhe synon vazhdimësinë e vlerave dhe trashëgiminë kulturore kombëtare në fushën e instrumentit Klarinetë me profilin mësuesi.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hyrje, Faqja zyrtare online, http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=8&niveli=65 - VKM 145, Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve, Evidenca I.I.1.1.11 - Statuti i Universitetit të Arteve, Evidenca I.I.1.2.1
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Duke u bazuar në hartimin dhe përshkrimin e programit të studimit me profil Master i Arteve në ‘Klarinetë dhe Mësuesi’, program ofrohet në përputhje të plotë me qëllimin e institucionit (në përgatitjen dhe specializimin e studentëve instrumentist me profil klarinetë, në mësuesi) dhe me legjislacionin e arsimit të lartë për mësuesi (Ligjit të Arsimit të Lartë nr.80/201).</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor,
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Planin Strategjik 2018-2025, të Universtetit të Arteve, si dhe Misioni & Profili të këtij universiteti, konstatohet se programi i studimit Master i Arteve ‘Klarinetë dhe Mësuesi’, është hartuar në përputhje të plotë me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së tij.</p>


<p>përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Konstatohet se, sipas Statutit, Planit Strategjik 2018-2025 të Universitetit të Arteve, dhe rregullores për programet e ciklit të dytë të studimit dhe rregullores së institucionit, ku programi studimit, Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi' është hartuar në përputhje të plotë me qëllimin, misionin dhe vizionin e universitetit në fushën e veprimtarisë së interpretimit të instrumentit klarinetë, me profil mësuesi.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i Universitetit të Arteve, Evidenca 1.1.1.2.1 - Plani strategjik i Universitetit të Arteve, 2018-2025 - Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte Klarinetë dhe Mësuesi 		
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Konstatohet se, programi i studimit, Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi', është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare, më ligjin e arsimit të lartë Nr.80/2015, në përgjigje të nevojave të tregut të punës. Politikat e Universitetit të Arteve, me statusin e veçantë si dhe me profilet e specifike të studimeve, mundësojnë regjistrimin dhe diplomimin e studentëve të paktë në numër dhe të mirëspecializuar (shiko mesataret e diplomimit në vite) dhe të përgatitur për tregun e punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konistë të kualifikuar për të performuar të gjitha gjinitë e muzikës si solistë, pjestarë të ansambleve si dhe pjesëtar të orkestrave simfonike dhe frymore apo baund-eve të muzikës moderne; • Mësues/instrukturë të kurrikulave artistike për arsimin parauniversitar; • Pedagogë për lëndët Klarinetë, Muzikë Dhome, Dëshifrazh dhe Vështirësi Orkestrale pranë FM të UART; • Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor - Raporti Vjetor i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti I Arteve 		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin dhe në vizitës vlereson se standardi I.1 programi i studimit që ofron Universiteti i Arteve është në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin rregullatore dhe ligjin e arsimit të lartë.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p> <p>plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi I.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Ëcb site: ccca.asca.al





Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit të Universitetit të Arteve, Fakultetit të Muzikës, Departamentit të Interpretimit, specifikisht programit të Master i Arteve në 'Klarinetë dhe Mësuesi', si dhe vizitës së GVJ-së në institucion, konstaktohet se, një përvojë e gjatë e institucionit (që tashmë gëzon edhe statutin e veçant) me një histori në themelimin e shkencës së artit për herë të parë në vendin tonë, gëzon përvojë në shtrirje kohore në të dy shekujt (60 vite që prej hapjes së institucionit). Kjo përvojë rezultoi e konsoliduar nëpërmjet aktiviteteve të shumta kulturore shkencore, me profilin e stafit akademik në fushën e artit, si dhe gëzon të gjithë kapacitetet akademike si burime njerëzore dhe infrastrukturë.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Profili i stafit akademik, CV, Faqja zyrtare online, Universiteti i Arteve, www.uart.edu.al - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve, 2021-2022 - Biblioteka e Universitetit të Arteve, http://ëëë.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=70&niveli=56
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha specifike e Masterit të Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi' paraqitet e qartë në përputhshmërinë me fushën e përgjithshme të Departamentit të Interpretimit, me diplomë Bachelor në Klarinetë, Fakultetit të Muzikës, Universiteti i Arteve. Përputhshmëria qëndron në profilin e studimit, si vazhdimësi e ciklit të parë të studimeve, në përputhshmëri me ligjin e arsimit të lartë për të formuar specialist instrumentash me profil mësuesie, në hartimin e programit akademik dhe kurrikulave të cilat reflektojnë me kohezion në përputhje me fushën akademike që ofrohet prej Departamentit të Interpretimit.</p> <p>Hartimi i programit Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi', është realizuar në përputhshmëri të plotë me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë që është Departamenti i Interpretimit dhe asaj kryesore të Fakultetit të Muzikës. Emërtimet, dhe klasifikimet kodifikimet janë përputhshmëri me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane (shpërndarja e ETCS sipas rëndësës së orëve në auditor dhe të studimit individual, paraqitet të ndryshme të lëndët, për arsye se profili i studimit është i specifikuar në instrumentin Klarinetë, si dhe statusit të veçantë që universiteti i Arteve gëzon).</p>

	<p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit, Departamenti i Interpretimit, faqja zyrtare online, http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=193&niveli=70 - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve, 2021-2022 - Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Klarinetë dhe Mësuesi.
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Universiteti i Arteve, nëpërmjet Fakultetit të Muzikës, Departamentit të Interpretimit, ofron programin e Master i Arteve ' Klarinetë dhe Mësuesi', i cili është vazhdimësia e programit Bachelor në Klarinetë. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhshmëri të plotë në fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, të njësisë kryesore dhe të profilit të universitetit. Emërtimi i këtij programi studimi, forma e paraqitjes së kurrikulave dhe profilit të studimeve, kohëzgjatja e studimit, profili i studentëve, përputhshmëria me unifikim e programit sipas udhëzimeve të arsimit të lartë Nr 80/2015 dhe shpërndarja e rëndësës së orëve për çdo lëndë (ECTS) janë në përputhje me standardet e vendosura kombëtare dhe evropiane. Ky profil studimi paraqitet si unik në Shqipëri dhe jep kontributin në plotësimin e tregut më specialist instrumentist me drejtim pedagogjik.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve, 2021-2022 - Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Klarinetë dhe Mësuesi. - Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor - Programi i studimit, Departamenti I Interpretimit, faqja zyrtare online, http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=193&niveli=70
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>NUK KA</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi' nga Departamenti i Interpretimit, në Fakultetin e Muzikës, nëpërmjet politikave të brendshme të paraqitura në rregullore dhe planin strategjik 2018-2025, si dhe profilit të Universitetit të Arteve, ofrojnë trajnime profesionale të paraqitura si aktivitete kulturore, për studentët aktual dhe për të diplomuarit (alumni).</p> <p>Trajnimet profesionale paraqiten si veprimtari artistike dhe kulturore.</p>

	<p>Gjithashtu, angazhimi në projekte akademike si Erasmus+, Erasmus + KA2, etj.</p> <p>Universiteti nëpërmjet politikave të tij, mundëson zhvillimin dhe mbajtjen e lidhjeve me studentët të cilët janë alumni nga institucioni.</p> <p>Një element shumë i rëndësishëm për tu theksuar, është përfshirja e studentëve aktual dhe të diplomuar në aktivitet e akademike të përkthyer si koncerte artistike.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, , Universiteti i Arteve, 2021-2022 - Planifikimi i personelit te FM nga DI - Raporti I Zyrës së Projekteve, upload në llogari të ekspertëve, nga ASCAL - Aktivitete kulturore shkencore, Statuti i Universitetit Të Arteve - Aktivitete kulturore shkencore, Plani strategjik I Universitetit të Arteve, 2018-2025 - Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte Klarinetë dhe Mësuesi 						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin dhe në vizitës vlereson se programi i studimit Master i Arteve në 'Klarinetë dhe Mësuesi; është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Në këtë institucion gjendet struktura e brendshme funksionale që mundëson përmbushjen e qëllimit dhe misionit në përputhje të plotë me ligjin.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="536 1093 906 1173"></th> <th data-bbox="906 1093 1104 1173">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1104 1093 1331 1173">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="536 1173 906 1214"></td> <td data-bbox="906 1173 1104 1214"></td> <td data-bbox="1104 1173 1331 1214">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi I.3 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri I. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nëpërmjet dokumentacionit dhe vizitës në Universitetin e Arteve, konstatohet se njësia bazë, Departamenti i Interpretimit, që ofron programin Master i Arteve në 'Klarinetë dhe Mësuesi', për kqyrje dhe mbarëvajtje bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionit siç janë departamentet dhe njësitë e tjera akademike dhe administrative (profili i universitetit u ofron departamente mundësi bashkëpunimi për shkak të ndërveprimit të nevojave që paraqesin në veprimtari të ndryshme akademike dhe kulturore/artistike, e cila është edhe në statutin e universitetit). Ky bashkëpunim, mundëson siguron mbarëvajtjen e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Feb site: www.ascal.al

 10



	<p>realizmit me sukses të programit të studimit Master i Arteve në 'Klarinetë dhe Mësuesi'.</p> <p>Deapartamenti, në hartimin dhe zbatimin e programit mësimorë (duhet të merret në konsideratë statuti i veçantë, ku mësimdhënia është e integruar me praktikën brenda dhe jashtë auditorit), bën ndarjen e detyrave dhe kordinimin mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar përgjegjësitë si në nivel akademik ashtu edhe nga pikëpamja administrative. Rregullore e Universiteti të Arteve, si edhe rregullore e programit janë të qarta në ndarjen e detyrave funksionale dhe mundësitë e bashkëpunimit, midis njësive të ndryshme në këtë institucion.</p> <p>Analizat vjetore të mbarëvajtjes dhe vazhdueshmërisë së punës, e paraqesin kordinimin midis personelit drejtues akademik, stafit akademik, personelit administrativ dhe studenteve.</p> <p>Duke marrë në konsideratë kulturën institucionale me qasje bashkëkohore dhe disiplinë orkestrative, konstatohet se fryma bashkëpunuese është e formalizuar dhe e informalizuar (komunikim institucional jo zyrtar të vazhdueshëm, nga lartë poshtë dhe nga poshtë lartë). Kjo sjellë si rezultat qasjen pozitive në organizimin institucional dhe reflektimin pozitiv në psikologjinë e bashkëpunimit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte Klarinetë dhe Mësuesi - Raporti i Vlerësimit të Brendëshme 2021-2022 , Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve,
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Universiteti i Arteve, për të realizuar objektivat e procesit mësimor e formues të studentëve, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, institucione të arsimit parauniversitar dhe institucione administrative brenda vendit. Profili i universteti, si dhe jetëgjatësia e këtij institucioni, është konsoliduar me marrëveshje institucionale të shumta.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe Brenda dhe jashtë vendit Shembull: Marrëveshje me Drejtoritë e Përgjithshme të ZVA / shembull /ZVA Vlorë
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj,</p>	<p>Nëpërmejt vlerësimit të dokumentacionit dhe vizitës zyrtare, konstatohet se, Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve në Universitetin e Arteve, realizon bashkëpunimin me institucionet homologe universitare dhe kërkimore dhe është ura lidhëse jashtë dhe brenda institucionit midis njësive bazë dhe kryesore. Këto bashkëpunime janë edhe në kuadër të projekteve të mëdha ndërkombëtare si Erasmus +, Erasmus KA2, MERITA etj.</p>

dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	<p>Në kuadër të projekteve të ndryshme ndërkombëtare të sipërpërmendura, konstatohet se realizohet përfshirja e numrit të lartë të studentëve të profilit të studimit të Masteri i Arteve në 'Klarinetë dhe Mësuesi'. Konstatohet se përfshirja në mobilitete e shkëmbimeve të studentëve, dhe stafin janë kthyer në traditë institucionale të këtij departamentit të instrumentit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statistika të Mobiliteteve Erasmus+ KA107 2018-2020 - Statistika të Mobiliteteve Erasmus+ KA 107 2020-2022 - Marrëveshjet, Faqja zyrtare online e Universitetit të Arteve, http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=1089&niveli=95 - Projektet, Faqja Zyrtare Online e Universitetit të Arteve, http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=784&niveli=156
---	---

Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Konstatohet se informacioni i hartuar për përfitimet nga marrëveshjet dhe bashkëpunimet, siç janë ato të projekteve dhe shkëmbimit të studentëve, janë në vazhdimësi për programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Vazhdimësia e projekteve dhe e shkëmbimeve u kufizua në vitin 2020 të pandemisë globale COVID -19 e cila mbylli mundësinë e shkëmbimeve për studentët dhe pedagogët për paraqitje fizike, por mundësoji bashkëpunimin online me masterclass të ndryshme. Raportet analitike vjetore për përfitimet nga marrëveshjet dhe bashkëpunimet, në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Fakulteti I Arteve, 2021-2022
---	---

Konkluzione	<i>GVJ vlereson se ky standart, nisur nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, rezulton se Departamenti i Intertpretimit, Fakulteti i Muzikës i Universitetit të Arteve, ka një sërë marrëveshesh me universitete dhe institucione të tjera që ndihmojnë për një cilësi në realizimin e programit të studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" si dhe për një aftësim profesional si artistik ashtu edhe pedagogjik. GVJ, vlereson se institucioni permbush plotësisht standartin e fushës I.</i>
--------------------	---


Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al




12



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregulatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga analiza e bërë planit mësimor të programit të studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi", konfirmojmë se plani mësimor është hartuar duke u bazuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar; Urdhrin e MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 "Per riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve, si dhe në Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS)</p> <p>Veprimtaritë formuese pjesë e këtij plani mësimor ABCDE janë konform udhëzimeve të MARS dhe përafësisht me përqindjet që kërkohen sipas këtyre udhëzimeve.¹</p> <p>plani mësimor i programit të studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" është i ndarë në Module dhe strukturohet si më poshtë:</p> <p>Moduli - LËNDË BAZË - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (24ECTS)</p> <p>Moduli - LËNDË KARAKTERIZUESE -përgatitje për disiplinën shkencore - artistike (53 ECTS)</p> <p>Moduli - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE - nëndisiplina, profile dhe gruplëndë me zgjedhje (9 ECTS)</p> <p>Moduli - LËNDË ME ZGJEDHJE (4 ECTS)</p> <p>Moduli - LËNDË PLOTËSUESE - praktika profesionale (8 ECTS)</p> <p>Moduli – DETYRIME PËRMBYLLËSE. (22 ECTS)</p> <p>Poashtu edhe sylabuset përmbajnë informacione të detajuara, si më poshtë:</p> <p style="text-align: center;">Kodi i lëndës Emërtesa e lëndës Semestri/Cikli Programi studimor Statusi i lëndës Qëllimi i lëndës</p>

	<p>Korrespondenca dhe korrelacioni i programit Përmbajtja e lëndës Semestri I (saggio — mbrëmje muzikore) / Semestri II (Provim) Mënyra e mësimdhënies Kontrolli i Njohurive Detyrimet e studentëve Mësimdhënia dhe vlerësimi i studentëve Kreditet dhe mënyra e zhvillimit të mësimdhënies për semestër ECTS koeficienti i ngarkesës së studentit Numri i orëve nëpër semestra Lëturë themelore Lëturë plotësuese</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar. - Urdhri e MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve.” - Rregullore mësimore e Ciklit të Dytë të studimeve Master . - Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte Klarinetë dhe Mësuesi . - Syllabuset e programit të studimit Master në Arte Klarinetë dhe Mësuesi. - Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Klarinetë dhe Mësuesi.
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga analiza e programi të studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” që ofrohet pranë Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve; rezulton se struktura e ndërtimit dhe përmbajtja e tij qëllimi dhe objektivat, realizojnë formimin e shprehive të veçanta si në fushën e muzikës ashtu edhe në fushën e mësimdhënies. Në planin mësimor lëndë të përfshira në veprimtaritë formuese B mundësojnë përvetësimin nga studentët si përvetësimin e teorive dhe parimeve akademike në fushën e muzikës ashtu edhe formimin e tyre me mjeshterinë e ekzekutimit dhe interpretimit të veprave në tërësinë e stileve muzikore. Si edhe u verifikua nga vizita në institucion numri I të punësuarve mbi 90 % të diplomuarve konfirmon se studentët e diplomuar kanë aftësitë dhe kompetenca për tu përgjigjur kerkesave të tregut të punës.</p> <p>Nga ana tjetër një analizë e syllabusve të veprimtarisë formuese A tregon se këto veprimtari japin mundësi studentëve të marrin njohuri dhe të formojnë shprehje dhe kompetenca në aspektin profesional në fushën e mësuesisë.</p>



<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga verifikimi i programi të studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” që ofrohet pranë Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve rezulton se ky program është realizuar konform udhëzimeve të MAS-së dhe udhëzimeve të vetë institucionit për praktikën profesionale dhe detyrimet mbyllëse. Në planin mësimor janë planifikuar dy praktika si ajo profesionale për mësimdhënien me 3 javë, dhe praktika artistike me ngarkesën 30/20 gjithsejt të dyja me 8 ECST. Rezulton se praktika mësimdhënien behet në shkolla sipas marrëveshjeve me ZAV-të ndërsa praktika artistike rezulton të behet nga përfshirja e studentëve në jetën koncertale të fakultetit të Muzikës. Ndërsa po në këtë plan detyrimet mbyllëse janë përcaktuar me një ngarkesë 2 orë në javë dhe 520 orë punë individuale të studentit me 22 ECTS.</p> <p>Gjatë vizitës në takimin me stafin dhe studentë u konfirmua se në semestrin e 4-tërt ngarkesa 2 orë në javë në auditor është edhe një mundësi takimi më udhëheqësin si dhe për të kontrolluar ecurinë e punës së studentit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nga analiza e programeve të studimit të nivelit bachelor në Klarinetë me programin Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”, mund të konfirmojmë se ka një vazhdimësi si nga ana strukturore por edhe në përmbajtje duke u bazuar si në qëllimet ashtu edhe objektivat e këtyre planeve. Dizenuar si Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” ai është në përputhje me ligjin 80/2015 dhe udhëzimet e MAS-së, duke synuar formimin shkencor dhe profesional të studentëve si si artistë dhe si mësues.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve në planin mësimor rezulton se Programi i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” është i organizuar sipas ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe shtojcës 1 të VK.M Nr. 41, date 24.01.2018 Per elementët e programeve të studimit të ofruara nga IA.L e ndryshuar. Ky program është më një kohzgjatje dy vite dhe ka 120 kredite . Veprimtaritë formuese A (Lëndë bazë -përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme) përbëjnë 24 ECTS por duke marrë si formim profesional edhe praktikën me 6 ECTS, bëhen gjithsejt 30 ECTS, duke plotësuar 25% të krediteve të kërkuara për këto programe studimi që përgatisin edhe mësues.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga grupi i vlerësimit të brëndëshëm rezulton se forma e organizimit të programit të studimit është me kohë të plotë në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, (neni 75.pika 4) statutit të Univeritetit të Arteve², si dhe rregullores se studimeve të këtij programi. Pranimi i studentëve bëhet me konkurs</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 922-43423


E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al

15

<p>arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>bazuar në rregulloren e programit të studimeve (neni 11), në kriteret e përcaktuara e të miratuara nga Fakulteti i Muzikës (shkresa Nr. 20/2. date 21.01.2022), në përputhje me nenin 76.pika 1;2;3, të ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe nenit 92 të statutit të institucionit.Rezulton se ka një rregullore të miratuar nga fakulteti dhe Senati për realizimin dhe procedurat e zhvillimit të konkursit të pranimit, dhe se kjo rregullore dhe procedurat publikohen në faqen zyrtare të UART-ve Rezulton se financimi i këtij programi studimi bëhet nga Departamenti i Interpretimit në përputhje me Statutit e institucionit (Neni 92/7), edhe VKM 780 datë 26.12.2018.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i Universitetit Të Arteve
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i Studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” rezulton se ofrohet vetëm në Departamentin e Interpretimit të Fakulteti i Muzikës të Universiteti të Arteve. Në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 ai është i ngjashëm me të gjithë Masterat e Arteve në Mësuesi që ofron kjo njësi duke përmbushur mbi 90% të programit të njëjtë sic kërkohet për mastera në të njëjtën fushë studimi, që ofron ky departament.</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” rezulton se ky program shoqërohet me kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra nga MAS. Programi përfshihet në fushën e studimit Arte dhe Shkencave Humane (kodi 02), si fushë e përgjithshme Arte (kodi 021) dhe fusha specifike Muzike dhe arte performuese (kodi 0215)</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Sipas Raportit të vlerësimit të Brendshëm dhe bashkëbisedimeve gjatë vizitës ky program nuk bënë pjesë në programet të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i vlerësimit të brendshëm.
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se lidhur me këtë standart programi i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” është tërësisht në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, (neni 75.pika 4) statutit të Univeritetit të Arteve, si dhe rregullores se studimeve të këtij programi.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X

Standardi II.2
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit konfirmojmë se njësia kryesore bazë për programin e studimit Masteri Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi", Fakulteti i Muzikës funksionon konform legjislacionit në fuqi. Fakulteti i Muzikës ka në përbërje të vet 3 Departamente: Departamentin e Interpretimit, Departamentin e Kompozicionit, dhe Departamentin e Kantos, duke përmbushur detyrimin e përcaktuar në Ligjin 80/2015, Neni 23/2.</p> <p>Departamenti i Interpretimit si njësia bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi është konform ligjit .</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve, 2021-2022
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga verifikimi i të dhënave në RVB dhe në takimin me drejtues të fakultetit, departamentit si dhe me Drejtorinë e Burimeve njerëzore rezulton se njësia bazë e programit të studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi", angazhon personel ndihmës akademik dhe administrative për realizimin e këtij programi. Angazhimi i personelit akademik për realizimin e praktikave mësimore bëhet me urdhër të brendshëm sipas rregullores së brendshme të institucionit. Deklarimet e bëra nga grupi i punës i RVB-së si Urdhër i brendshëm për angazhimin e personelit akademik për realizimin e praktikave mësimore; Skeda e studentit praktikant; Marreveshja e praktikës; Formulari I vlerësimit për studentin u verifikuan gjatë vizitës.</p> <p>Institucioni angazhohet dhe vë në dispozicion laboratorët dhe infrastrukturën teknologjike për përgatitjen e tezave dhe të detyrave përgjatë arritjes së qëllimeve dhe objektivave të programit. Institucioni ka personel ndihmës për pajisjet e teknologjisë mësimore dhe mirëmban pajisjet kompjuterike në laboratorin e informatikës. Numri I punonjësve ndihmës për laboratorët dhe teknikës është 7 dhe janë të diplomuar në profilin e studimeve që ofron universiteti.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al

17


	Referencë: - Planifikimi i personelit te FM nga DI - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve, 2021-2022		
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Konfirmojmë se ka një program lënde për praktikën artistike dhe mësimdhënies pra rezulton se njësia përgjegjëse e këtij programi studimi ka caktuar nga një përgjegjës për realizimin e tyre.		
Konkluzione	<i>GVJ vlerësom se njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, ka një personel të mjaftueshëm ndihmës si akademik dhe administrativ të mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit, dhe ka organizuar praktikat si artistike ashtu edhe mësimore në përputhje me rregulloret e institucionit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga verifikimi i dokumentacionit që disponon njësia kryesore e programit të studimit rezulton se Fakulteti i Muzikës ka tërë informacionin e nevojshëm si për organizimin e programit ashtu edhe për strukturën dhe përmbajtjen e tij. Fakulteti disponon të gjitha vendimet e marra nga Senati për organizimin e këtij programi, rregulloren e studimit të këtij program ku përcaktohen në detaje struktura, dhe përmbajtja, rregullorja e pranimit me kriteret dhe procedurat e realizimit të konkursit, etj. Në RVB të gjithë këto dokumenta janë pasqyruar me evidenca, por janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të UART-së.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Konfirmojmë se pjesë e këtij programi të studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” është edhe plani mësimor i detajuar sipas udhëzimeve të MAS-së dhe të rregulloreve të miratuara për këtë program studimi. Në planin mësimor ndarja e lëndëve është bërë sipas të VK.M Nr. 41, date 24.01.2018 Per elementët e programeve të studimit te ofruara nga IA.L e ndryshuar. Janë të pasqyruara ngarkesa e lëndëve, raporti brenda dhe jashtë auditorit, pikët kredite etj.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e	Në rregulloren e studimit të programit të studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” të miratuar në Senatin Akademik me vendimin

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëbë site: www.escal.al



18



<p>nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nr.58 datë 13.09.2022, si dhe rregullorja e konkursit të pranimit Nr.20/1 datë 02.01.2022, rezulton se ka tërë informacionin e nevojshëm lidhur me pranimin e studentëve (neni 12), transferimin e tyre (neni 24).</p> <p>Në vizitën në institucion në takimin me sekretarinë mësimore dhe me studentë u konfirmua se në rregulloren e këtij programi studimi të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të fakultetit, studentët marrin tërë informacionin e plotë lidhur me konkurset e pranimit ashtu edhe ekuivalentimin e studimeve (në rastet e mobiliteteve te studenteve në kuadrin e projekteve Erasmus) apo edhe transferimin e studimeve, ndonëse nuk ka asnje transferim.</p>		
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit si përgjegjës i realizimit të këtij programi studimi zotëron të programet lëndore syllabuset pjesë e planit mësimor të programit të hartuara sipas udhëzimeve dhe rregullores së këtij program studimi, si elementet e kërkuar sipas VKM Nr. 41 date 24.01.2018 i ndryshuar dhe formatit të miratuar në nivel institucioni.</p>		
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Ndonëse ka një analizë që bëhet për realizimin dhe cilësinë e programi të studimit Master i Arteve në “ Klarinetë dhe Mësuesi” nga njësisia bazë dhe komisioni I ngritur për sigurimin e cilësisë, të miratuar nga Rektori dhe të dërguar më pas njësisë përgjegjëse, nuk ka patur asnjë ndryshim në këtë program.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se Programi i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” është i organizuar dhe strukturuar në përputhje me objektivat formuese të një programi të nivelit të dytë, duke përmbushur të gjitha kriteret që kërkohen.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>


<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të</p>	<p>Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur rezulton se programi i studimit Master i Arteve në “ Klarinetë dhe Mësuesi ” i ofron studentëve orë të nevojshme e të mjaftueshme teorike e praktike për një thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme por edhe punësimin e të tyre. Gërshëtimi i lëndëve pedagogjike më ato artistike ndihmon në aftësimin e zhvillimin e tyre profesional për punësimin e tyre të ardhshëm.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Ëëb site: www.ascal.al

19

mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Ky program studimi është një vijim i thelluar i njohurive të marra në nivelin e parë të studimit Bachelor por duke patur si risi ofrimin për studentë të mundësinë të marrin informacion në fushën didaktike e praktike të mësimdhënies.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” është strukturuar në veprimtari formuese A;B;C;D;E. që realizohen në një shtrirje kohore 2 vjecare me 4 semestra me 120 kredite (ECTS) Vlerësimi i punës së studentëve është 25 ore për një kredit dhe nënkupton si vlerësimi i punës në auditor ashtu edhe punën e pavarur të tyre jashtë auditorit. Mendojmë se duhej të ishin evituar lëndë me një ngarkesë mësimore 25 ore pra me një kredit, pasi nuk janë të përshtatshme për një nivel studimi master dhe duhet të kishte lëndë për aftësimin e studentëve për kërkimin shkencor në formë metodike kërkimi shkencor. Mendojmë se ky strukturim i planit mësimor mundëson realizimin e objektivave të këtij programi, si dhe arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Rezulton se struktura e programit, plani mësimor si pjesë e tij, ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe bazuar edhe në eksperinca ndërkombëtare. Plani mësimor i programit ka dhënë shumë përparësi ushtrimeve apo seminareve në raportin teori praktikë, duke synuar zhvillimin e karrierës artistike të studentëve si dhe aftësimin në mësimdhënie për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Duke analizuar planin mësimor të programit të studimit Master I Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” në aspektin e raporteve mes lëndëve të shtrira sipas veprimtarive formuese dhe raportin teori praktikë brenda vetë lëndëve të një tipi veprimtarie, rezulton se ai i krijon mundësi studentëve jo vetëm që të kenë hapësira më të mëdha punësimi por edhe mundësinë për njohjen dhe transferimin e studimeve dhe realizimin e mobiliteteve në universitete homologe jashtë vendit.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Pavarësisht se çfarë deklorohet në RVB-në e paraqitur nga grupi i punës që është e lidhur me natyrën dhe statusin e vecantë të programeve që ofron, <i>nuk konsiston se ka një përditësim të programeve të lëndëve</i> , e cila duhet të jetë e dokumentuar në mbledhjet e departamentit dhe miratimin e tyre çdo vit akademik Në shqyrtimin e programeve lëndorë gjatë tre viteve rezulton se ka një përditësim të literaturës, por jo ndryshime në përmbajtjen e programit.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e	Nga analiza e përmbajtjes së programit të studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” mund të konfirmojmë se mundëson formimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në përputhje me objektivat dhe synimet

dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara.	e përcaktuara në këtë program. Fakti që studentët janë pjesëmarrës në koncerte dhe janë pothuajse tërësisht të punësuar si edhe u verifikua nga vizita në institucion, e konfirmon këtë gjë.		
	Referencë: - Raporti i Vlerësimit të Brendëshme 2021-2022 , Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve		
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Rezulton se përmbajtja e Programit të Studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" i jep mundësinë studentëve që janë diplomuar për të vazhduar studimit në nivelin e tretë të studimeve për doktoraturë. Ne nenin 69 të rregullores së studimit të Universitetit të Arteve theksohet se në studimet doktorale te nivelit të tretë mund të vazhdojnë edhe studentët që kanë fituar një diplomë në Master i Arteve.		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se struktura dhe përmbajtja e programit të studimeve Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe objektivat e programit, duke garantuar formimin e kompetencave si artistike dhe mësimdhënëse në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Punësimi i të diplomuarve mbi 90% verifikuar gjatë vizitës e konfirmon këtë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur lidhur me programin Master i Arteve në " Klarinetë dhe Mësuesi" rezulton se ky program është hartuar bazuar në urdhërin Nr. 616 datë 30.12 2016 dhe Nr. 821 datë 26.12.2018 I MAS-se për verifikimin e pershtatshmërisë të programeve të studimit të ciklit të dytë në fakultete të Universitetit të Arteve si dhe të vendimit të hapjes së këtij programi. Nga verifikimi I dokumentacionit mund të konstatohet se është bërë një punë e mirë për hartimin e tij duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës, dhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë si institucione homologe, të diplomuar, përfaqësues të institucioneve arsimore etj.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për	Gjatë vizitës u konfirmua se Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit ku ofrohet programi i studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi", realizon një feedback me studentët dhe strukturat e tyre, mban dhe merr sugjerime nga studentët e diplomuar, shfrytëzon projektet

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëëb site: www.ascal.al

21


përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	e përbashkëta që ka me partnerët të huaj, me synimin për përmirësimin e programit të studimit.								
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Fakulteti i Muzikë, Departamenti i Interpretimit ku oftohet programi i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”, deklaron se konsideron proces të përmirësimit, përditësimit dhe përshtatjen e programit të studimit, propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme, bashkëpunimin me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione, përvojën akademike të fituar si dhe shkëmbimet të personelit akademik në kuadër të mobiliteteve Erasmus+ KA 107, organizimit të Master classeve por nuk rezultojnë se ka ndonjë ndryshim, apo përshtatje të këtij programi, pasi ka pak vite që është hapur dhe rezultatet dhe objektivat janë arritur. Referencë: - Statistika të Mobiliteteve Erasmus+ KA107 2018-2020 - Raporti i Vlerësimit të Brendëshme 2021-2022 , Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve								
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se njësia përgjegjëse organizon një sërë bashkëpunimesh dhe veprimtarish që synojnë përmirësimin e programit të studimit me një sërë aktorësh profesionistë të fushës, me pjesëmarrje në projekte me partnerë të huaj, por nuk rezultojnë se ka ndonjë ndryshim të këtij programi, pasi është arritur qëllimi dhe objektivat e programit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe analizës së programeve të lëndëve të programit të studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” rezultojnë se janë përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat e Universitetit të arteve, Fakultetit të Muzikës dhe Departamentit të Interpretimit. Përmbajtja e lëndëve dhe strukturimi i tyre janë në funksion të formimit të studentëve me bazat didaktike, muzikore dhe kulturore të koncertimit në Klarinetë , rritjes së mjeshtërisë të ekzekutimit dhe interpretimit të veprave në tërësinë e stileve muzikore, aftësimi të tyre në mësimdhënie për të gjithë sistemin arsimor.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe	Nga takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion me drejtues të njësive kryesore dhe njësive bazë si dhe me stafin akademik rezultojnë se

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëmb site: www.ascal.al





<p>administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>ka një bashkërendim të tërë strukturave të angazhuara në realizimin e programit të studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" (të Sekretarisë mësimore, Sektorit mësimor dhe të kurrikulës, Burimet njerëzore, Zyra e projekteve, Zyra e informacionit protokoll /arkivës) dhe orësim e mbështetje për veprimtaritë artistike dhe shkencore, duke respektuar lirinë akademike të personelit të përfshirë në këtë program.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti I Zyrës së Projekteve, upload në Hlogari të ekspertëve, nga ASCAL - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Interpretimit, Universiteti i Arteve, 2021-2022 						
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga një analizë e veprimtarive të organizuara nga Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit rezulton se në Programin e studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" studentët angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore si nepërmjet detyrimeve që kanë gjatë vitit në lëndë të ndryshme por edhe nga pjesëmarrjes në aktivitetet artistike dhe kërkimore artistike që organizohen në Departamentin e Interpretimit apo dhe të Fakultetit të Muzikës. Konstatohet se studentët me të dalluar përzgjidhen dhe angazhohen në projekte bashkepunimi me Orkestrën e TKOBAP, në Master Classset apo te sektorit jopublik, përmes OJF në fushën e muzikës.</p>						
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i buxhetit të Universitetit rezulton se Fakulteti i Muzikës me miratimin e Bordit të Administrimit të UART ka mbështetur Departamentin e Interpretimit në kuadër të pajisjes me instrumente muzikore të tipologjive të apo edhe në aktivitetet kërkimore/artistike të festimit të 60 vjetorit të Fakultetit të Muzikës me dhënien e ambienteve të UART-së falas dhe mbulimin e materialeve logjistike dhe komunikimit. Një ndihmesë e madhe për stafin akademik kanë qënë edhe mbështetja financiare nga projektet apo edhe nga organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me partnerë të huaj në kuadrin e këtyre projekteve .</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se programi Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" ka përcaktuar prioritetet objektivat dhe qëllimet në aspektin e studimit dhe të kërkimit shkencor. Realizimi i tyre bëhet bazur në një bashkëpunim të efektshëm të tërë njësisë të UART-së dhe Fakultetit të Muzikës, duke përfshirë dhe nxitur aktivisht studentët në këtë proces.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Është site: www.ascal.al


<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit, si pjesë e Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve dhe përgjegjëse e programit të studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” rezulton se operon në koordinim me grupet lëndore që janë pjesë e strukturës së saj për realizimin e objektivave të programit të studimit që lidhen me kërkimin shkencor.</p> <p>Rezultoni se njësia kryesore përgjegjëse për realizimin e programit, për vetë natyrën specifike që ka institucioni, ka mbështetur grupet mësimore në projekte shkencore dhe përfshirjen e të rinjve në projekte dhe produkte artistike e kërkimore në fushën e muzikës bashkëkohore.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ u njoh me një sërë veprimtarish artistike që ka organizuar njësia me rrastin e 60 vjetorit të UART ku u theksuar se janë realizuar 60 ditë koncerte tërësisht me stafin dhe studentë të këtij institucioni, si dhe veprimtari të tjera artistike në bashkëpunim me pedagog të huaj edhe në kuadrin e Master Classeve.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Departamenti i Interpretimit, si pjesë e Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve dhe përgjegjëse e programit të studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” rezulton se aktualisht është e angazhuar nepërmjet strukturave të saj në projekte kërkimore, si në kuadër të financimeve të huaja apo vendase, ashtu edhe në veprimtari me natyrë ekspertize të kërkuara nga institucione të ndryshme në vend, (personeli akademik pjesëmarrëse në juri në Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe Gjirokastër).</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit, si pjesë e Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve ku ofrohet program i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”, në përputhje me statusin që ka, konfirmojmë se ka organizuar një sërë aktiviteteve artistiko shkencore, që lidhen me realizimin e objektivave të syllbuseve të këtij programi si pjesëmarrje në koncerte, festivale, konkurime, etj.</p> <p>Rezultoni se ky departament është pjesë integrale edhe e një sërë projektesh shkencore me partnerë evropianë në kuadrin e të cilëve ka organizuar dhe ka marrë pjesë në koncerte, takime dhe konferenca shkencore.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Gjatë vizitës u konfirmua nga dokumentacioni i verifikuar, angazhimi e një numri studentësh në institucione artistike në vend gjatë viteve 2019-2022 (6 studentë punësuar në shkollat e mesme artistike; orkestrën e forcave të armatosura) apo pjesëmarrje në audicione për pozicione në orkestrat e të rinjve të krijuara në kuadër të nismave rajonale si CEMAN (Central European Music Academies Network,) gjë e cila tregon se në këtë program është punuar mirë për formimin e profesionistëve konkurrues për tregun e punës si brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale,</p>	<p>Duke analizuar strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” objektivat e tij për formim të studentëve si në aspektin artistik por edhe mësimdhënës mund të konkludojmë se Departamenti i Interpretimit përgjegjës për këtë program</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

24

për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	studimi ka marrë në konsideratë të gjitha sugjerimet nga MAS, (udhëzimi nr.100 datë 25.02.2022) institucioneve të tjera, kërkesave të tregut të punës, lidhur me e studentëve të tyre me mundësinë për licensimin në profesionin e mësuesisë. Referencë: - Udhëzimi nr.100 datë 25.02.2022 - MAS Ligji Nr. 10. 171, date 22.10.2009 Për profesionet e rregulluara		
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Rezulton se program i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe udhëzimet e MAS për profesionet e rregulluara ku përfshihet edhe mësuesia si pjesë e formimit të studentëve të këtij programi (Ligji Nr. 10. 171, date 22.10.2009 Për profesionet e rregulluara). Referencë: - MAS Ligji Nr. 10. 171, date 22.10.2009 Për profesionet e rregulluara		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Programi i studimit Maser i arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” bashkërendon veprimtaritë e tërë strukturave të saj për realizimin e objektivave të programit të studimit dhe veprimtarisë artistike dhe shkencore, me një pjesëmarrje dinjitoze me partnerë ndërkombëtarë, me një angazhim të studentëve cilësor në këto veprimtari. Ajo ka zbatuar të gjitha aktet ligjore lidhur me kërkesat që lidhen për profesionin e rregulluar në fushën e mësuesisë. Standartet përmbushen plotësisht!</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi / ekspertëve


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Rezulton se Universiteti i Arteve ka përcaktuar nepërmjet një sërë dokumentash të miratuara format e mësimdhënies me të cilat realizohet procesi mësimor. Këto forma të mësimdhënies janë të përcaktuara në rregulloren e Fakultetit të Muzikës neni 34 Mësimdhënia; si dhe në programet e lëndëve.</p> <p>Edhe praktika profesionale është organizuar dhe zbatuar, bazuar në urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr.1305 datë 25.02 2022 për rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale, dhe rregullore e studimit të programit Masteri Arteve.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte (Klarinetë dhe Mësuesi)
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Duke shqyrtuar dokumentacionin e departamentit që zbatohet për mësimdhënien, lidhur me programet e studimit të nivelit të dytë si dhe nga një analizë e syllabuseve të programit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi", mund të konstatojmë se personeli akademik që është përfshirë në realizimin e këtij programi përdor forma dhe metoda mësimdhënese në përputhje me natyrën e programit dhe të mundësive të studentëve.</p> <p>Për specifikën që ka institucioni format e mësimdhënies janë në përputhje me këtë specifikë si leksione speciale individuale, saxho, mësim ansambël në grup, ushtrime etj.</p> <p>Në një shqyrtim të syllabuseve rezulton se zbatohen edhe forma të tjera si punime individuale, esse dhe detyra, koncerte etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësit.</p>	<p>Universiteti i Arteve dhe Fakulteti i Muzikës rezulton se mbështet pedagogët për kualifikimin e tyre si në aspektin artistik ashtu edhe didaktik duke krijuar mundësi si në shfrytëzimin e infrastrukturës së institucionit ashtu edhe në pjesëmarrjen e tyre në projektet e ERAZMUS + në veprimtari me karakter didaktik. Kjo e drejtë dhe detyrim I personelit për trainim dhe kualifikim është pasqyruar edhe në Statutin e UART neni 68 " Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik"</p> <p>Një aspekt I rëndësishëm I përmisimit të kompetencave didaktike është edhe pjesëmarrja në Master classe dhe koncerte të cilat rezultojnë se janë të shumtë në këtë institucion.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ERASMUS statistika, Rregullorja e Departamentit të Muzikës - neni 28. pika 14;16; 17
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe CV-ve të stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi rezulton se pedagogët që japin mësim në këtë program janë personalitete të njohura në fushën e artit me një eksperiencë shumëvjeçare si në aspektin artistik ashtu edhe në</p>

<p>ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>mësimdhënie. Për vitin akademik 2021-2022 nga 17 pedagog PAE të përfshirë në mësimdhënie ne programin e studimit, 7 janë me titullin Profesor; 4 Prof.associuar; 2 me titullin Doktor dhe 4 Asistent lektor, ndërsa staf PAK i ketij programi jane 3 pedagogë nga të cilët 2 me titull Doktor dhe 1 Asistent lektor.</p> <p>Po ashtu rezulton se edhe pedagogët që mbulojnë lëndët didaktike kanë kualifikim e duhur sipas ligjeve dhe udhezimeve në fuqi.</p> <p>Nga analiza e syllabuseve kupton se stafi akademik përdor forma të larmishme mësimdhënie bashkëpunese duke integruar studentët në procesin mësimor dhe ruajtur marrëdhënie korrekte me to. Pjesmarrja e studentëve së bashku me stafin në koncerte apo vepritari artistike janë një pasqyrë e mirë e këtyre marrëdhënieve, dhe e zbatimit të kodit të etikës që funksionon në këtë institucion.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Profili i stafit akademik, CV, Faqja zyrtare online, Universiteti I Arteve, www.uart.edu.al
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Ne dokumentacionin e Fakultetit të Muzikës dhe në Departamentin e Interpretimit janë përcatuar detyrimet e pedagogëve për një mbarëvajtje të procesit mësimor (neni 28. pika 14;16; 17; i rregullores se Departamentit të Muzikës si dhe neni 14 i rregullores së studimit të programit) ashtu edhe format dhe mënyrat e vlerësimit të mësimdhënies së stafit akademik në analizat vjetore dhe pyetsorët me studentë.</p> <p>Nga takimi me studentë rezulton se departamenti jo vetëm që ka përfshirë studentët në këtë proces, por edhe ka reflektuar ndaj sugjerimeve të tyre. Studentët e vitit të dytë të studimeve deklaruan se ka patur një rast të tillë kur është marrë në konsideratë sugjerimi i tyre për të ndryshuar në planin mësimor nga simestrale në shtrirje vjetore ngarkesën e lëndës Histori muzike dhe Histori e estetikës muzikore.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Fakultetin e Muzikës dhe verifikimit gjatë vizitës në këtë fakultet rezulton se janë ngritur struktura apo njësi të cilat ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies, nepërmjet kordinimit të veprimtarisë së tyre si grupet mësimore, sekretaria mësimore dhe komisioni që është ngritur për sigurimi e cilësisë.</p> <p>Perdorimi i masterclasseve si forme shkembimi të eksperiencave mësimdhënëse, mes stafit akademik dhe pedagogëve të huaj të ftuar është një formë e rëndësishme që ndihmon në zhvillimin dhe përdorimin e metodave të reja inovative.</p>





mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në takimin me drejtuesin e zyrës së projekteve u konstatua se pjesmarrja në projekte me universitete homologe jashtë vendit rezulton si një mundësi trainimi për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse.		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka sanksionuar me rregullore forma të larmishme mësimdhënie në përputhje me specifikën e tyre si institucion artistik, për një proces të nxëni dhe aftësim profesional e shkencor të studentëve, duke integruar dhe nxitur studentët në këtë proces .Standarti përmbushet plotësisht!</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Në rregulloren e Departamentit të Interpretimit kreu V nenet 29;30;31;32 janë përcaktuar qartë mënyrat format dhe kriteret e vlerësimit të studentëve të të gjitha programeve të studimit.</p> <p>Mënyra e vlerësimit kriteret parakushtet për të hyrë në provim, sezonet e kontrollit të dijes janë të përcaktuara edhe në rregulloren e studimit të Masterit të Arteve në Klarinetë dhe Mësuesi , si dhe syllabuseve të programit. Këto rregullore janë të publikuara në faqen zyrtare të UART-së.</p> <p>Njohja e studentëve me rezultatet e vlerësimit të tyre bëhet nepërmjet sistemit të menaxhimit të vlerësimit të studentëve (ESSE3) aktualisht sistemi PITAGOR.A, përmes të cilit, jo vetëm dokumentohen testimet dhe vlerësimet e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve të program të studimit Master i Arteve ne “Klarinetë dhe Mësuesi” por edhe mundësohet komunikimi i drejtperdrejtë me studentet oboiste, lidhur me vendosjen e rezultateve në databazen e UART.</p> <p>Referencë:</p> <p>- www.uart.edu.al</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Mënyra e vlerësimit të studentëve sipas rregullores së UART obligon pedagogët ta bëjnë prezent para studentëve në orën e parë të mësimit të gjitha format dhe kriteret e vlerësimit. Gjatë takimit me stafin akademik dhe me studentët u konfirmua se ato njihen me përmbajtjen e lëndës dhe me format e vlerësimit në orën e parë të mësimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al



28



lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Në sekretarinë mësimore na u komunikua se po punohet për të digitalizuar edhe syllabuset me qëllimin që studentët të kenë akses online dhe të njihen si me përmbajtjen e lëndëve por edhe me format e vlerësimit të tyre.</p> <p>Referencë:</p> <p>- Rregullorja e UART , neni 78</p>		
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Duke ju referuar rregullores së studimit të Departamentit të Interpretimit si dhe rregullores së studimit të programit të studimit të nivelit të dytë neni 20 rezulton se përdoren një tërësi formash testimi dhe vlerësimi, dhe ka një sistem vjetor vlerësimi. Rezulton nga studentët se vlerësimi i tyre është një sistem që përmban edhe vlerësimin e performancës së tyre gjatë vitit dhe vlerësim të njohurive teorike. Këtë mënyrë vlerësimi u konstatua gjatë vizitës se behej edhe në mbrojtjen e diplomës, ku studentit përveç performancës me instrument, paraqiste edhe një mikrotezë, ku trajtohej teorikisht pjesa që ai luante me instrument.</p>		
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se në realizimin e programit të studimit Master i Arteve në "Klarnetë dhe Mësuesi" stafi akademik përdor konform rregulloreve të miratuara forma të larmishme mësimdhënie dhe kontrolli në përputhje me specifikën e natyrën e institucionit . Rezultatet e arritura në aftësimin artistik të studentëve e konfirmojnë këtë gjë.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e Departamentit të Interpretimit dhe në rregulloren e studimit të Masterit të Arteve në Klarnetë dhe Mësuesi rezulton se janë përcaktuar qartë që vlerësimi përfundimtar reflekton rezultatin integral të të gjithë vitit sipas syllabusit të lëndës respektive dhe duhet të reflektohet në vlerësimin përfundimtar..</p> <p>Periudha kohore e marrë në shqyrtim shtrihet ne te gjithe vitin akademik dhe cdo lëndë ka mënyrën e vet specifike të vlerësimit dhe raporte të ndryshme të elementëve që janë fleta e provimit dhe procesverbali i vlerësimit.</p> <p>Në takimin me studentë dhe stafin akademik të programit të studimit u konstatua se gjatë tërë vitit ngrihet një komision i cili verifikon format dhe mënyrat e vlerësimit të studentëve. Studentët deklaruan se vlerësimi i tyre shtrihet gjatë tërë vitit si për performancën e tyre në instrument</p>

	<p>por edhe më provime dhe kolegume në pjesën teorike të programit të lëndës.</p> <p>Referencë:</p> <p>- Rregullores së studimit Master i Arteve, Neni 21</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimiit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Për lëndët profesionale artistike vlerësimi bëhet me interpretim muzikor në kohë reale dhe me praninë e publikut, duke shmangur në këtë mënyrë ndonjë formë abuzimi dhe subjektivizmi në vlerësim.</p> <p>Për lëndët teorike u verifikua se përdoren sekretimi i fletës së provimit, që jep mundësi të ketë objektivitet në vlerësim, por mendojmë se në kushtet e sotme duhet të aplikohet sistemi elektronik i testimiit dhe vlerësimit, sistem që sipas deklaramit të studentëve ishte përdorur gjatë pandemisë me platformat Moodle dhe Teams.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>U verifikua pranë sekretarisë mësimore se syllabuset kishin të përcaktuar qartë mënyrat dhe format e vlerësimit, gjë e cila u konfirmua në takimin me studentë.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në takimin me studentë u verifikua se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet edhe me komente e diskutime të hapura përpara të gjithë grupit të studentëve dhe lidhet me këshilla të vlefshme nga artistet e afirmuar të personelin pedagogjik akademik mbi procesin e të nxëniet dhe ndihmon për të projektuar punën në të ardhmen. Duke u nisur nga natyra e lëndëve dhe forma e vlerësimit që ka në themel performancën e studentit në instrument dhe që realizohet gjatë tërë vitit në orët e punës individuale me to, studentët deklaruan se feedbacku i pedagogut është gjithmonë i pranishëm dhe i ndihmon të përmisohen në performancën e tyre me instrumentin.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në dokumentacionin që zotëron njësitë përgjegjëse e programit të studimit janë të përcaktuara qartë procedurat e realizimit të provimeve për të shmangur kopjimin apo plagjiaturat. Në provimet teorike zbatimi i elementëve të tillë si identifikimin e studentit nëpërmjet një dokumenti zyrtar (id,pasaportë et/), ndalimin e aparaturave të teknologjisë, të cilat nuk janë pjesë e zhvillimit të provimit (telefon, etj), ndalimin e pranisë së personave që nuk kanë lidhje me testimin, sekretimin e provimin me shkrim për të ruajtur anonimatit e studentit dhe vlerësimet subjektive të mundeshme, janë pasqyruar në rregullore të studimit të ciklit të dytë Master I Arteve.</p> <p>Takimi cdo javë me pedagogun udhëheqës gjatë përgatitjes së diplomës deklarohet nga drejtuesit e njësive se është një formë e mirë për të shmangur plagjiaturën.</p> <p>Referencë:</p> <p>- Rregullores së studimit Master i Arteve neni 20, pika 8,9,10</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale</p>	<p>Nga verifikimi i formave dhe procedurave të vlerësimit rezultojnë rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në</p>


bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	meritë dhe realizohen mbi bazën e meritës sipas specifikimeve respektive të rregullores së studimeve dhe vlerësimit gjatë gjithë kohës së zhvillimit të lëndës së syllabusit të programit mësimor. Për më tepër, ballafaqimi i vazhdueshëm me publikun dhe komisionet e audicioneve apo konkurseve të ndryshme, i bëjnë të painteresuar si studentin, ashtu edhe pedagogun që të vendosë rezultat të pabazuar në meritë.		
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga rishikimi i dokumentacionit rezulton se në nenin 20 pika 13;14 të rregullores të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve janë të pasqyruara të gjitha procedurat për njohjen e studentit me vlerësimin dhe garantohet e drejta e studentit për raste kur ka kontestim të vlerësimit. Në takimin me studentë u konfirmua nga ata se nepërmjet platformës Pitagora dhe me E- Mail merrnin në kohë vlerësimin e anës teorike të provimit të kryer, si dhe i njihnin mirë procedurat e rishikimit të vlerësimit, anikimin , ngritjen e një komisioni të ri vlerësimi, ndonëse nuk kishte patur ndonjë rast të tillë. Referencë: - Rregullorja e Studimeve të ciklit të Dytë Master, Faqja Zyrtare online, www.uart.edu.al		
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në nenin 20 pika 17 të rregullores të studimit të ciklit të dytë Master I Arteve janë të pasqyruara të gjitha procedurat për rastet kur ka ankimim lidhur me vlerësimin e studenteve. Në këtë rregullore janë pasqyruar të gjitha të drejtat e Dekanit të Fakultetit për anulimin e vlerësimit të bërë dhe ngritjen e komisionit të ri të rivlerësimit të studentit. Nga vizita rezultoi se nuk ka patur asnjë kërkesë për ankimim nga ana e studentëve në këtë program.		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni përdor forma dhe procedura të vlefshme vlerësimi duke garantuar një vlerësim objektiv dhe në kohë nepërmjet platformës Pitagora dhe performancës para publikut për lëndët artistike, por duhet të fillojë edhe kontrollin me sistemin elektronik dhe antiplagjiaturë të provimeve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësi krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Duke bërë një analizë të strukturës dhe përmbajtjes të dy planeve mësimore atij të nivelit bachelor dhe master i arteve rezulton se programi i studimit Master i Arteve në "Klarnetë dhe Mësuesi" jo vetëm që është një vazhdimësi logjike me programin bachelor në aspektin e realizimit


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Feb site: www.ascal.al

	të synimeve dhe objektivave të tij, por edhe synon thellimin e mëtejshëm të njohurive dhe aftësimin e tyre profesional. Strukturimi i këtij programi jep mundësi studentëve që të zhvillojnë aftësitë profesionale dhe artistike në një qasje ndërdisiplinore por edhe krijimin e mundësive për tregun e punës s edhe si specialist i artit dhe si mësues.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në programin e studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" rezulton se ka një lëndë (Informatike e aplikuar) e cila ka si objektiv të saj zhvillimin e aftësive teknologjike në shërbim të profesionit të tyre.Si edhe konstatohet nga qëllimi i lëndës studenti aftësohet për realizimin e një projekti individual dhe të pavarur rregjistrimi, masterizimi dhe realizimi në CD audio të performancës së tyre solistike. Rregullorja programit të studimit Master i Arteve, përcakton qartë që studenti që rregjistrohet në këtë program studimi duhet të zotërojë një nga 5 gjuhët e huaja të Bashimit Europian gjë e cila zbatohet për këtë program.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimi me stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i syllabuseve konstatohet se ka një feedback lidhur me rezultatet e arritura nga studentët sidomos në lëndët artistike, ku vihen në dukje sidomos mangësitë që shërbejnë për përmisimin e performancës në insrtument. Në disa lëndë u tha nga stafi akademik në takim për vetë natyrën e tyre ka 2 ose 3 titullarë që firmosin, ndaj cdo sugjerim që vjen nga studentët pasqyrohet në programin e lëndës. Kjo gjë u konfirmua edhe nga studentët në rastin e lëndës Histori e Muzikës dhe Histori e Estetikes muzikore.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t' u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga shqyrtimi i syllabuseve rezulton se ka një përqindje të madhe të karakterit praktik, apo zbatimit të metodave dhe aktivitetetve nga pedagogët në klasë, duke krijuar klimën e përshtatshme për pjesëmarrje të studentëve dhe mbështetjen e ideve inovative.
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe	Për vetë natyrën e fakultetit si fakultet i muzikës , orët e hapura e seminarët për zhvillimet e reja të shkencës (muzikës) rezulton se janë të lidhura me veprimtaritë e organizuara jashtë auditorit si koncerte apo


teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	evente koncertale etj. Me rastin e 60 vjetorit të UART u organizuar 60 ditë koncerte jashtë procesit mësimor.		
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga takimi me drejtues të fakultetit dhe me studentë rezulton se institucioni konsideron si ide inovative, evoluimin e gjuhes, mjeteve shprehëse të krijimtarisë dhe interpretimit bashkëkohor si dhe interpretimin e veprave të reja premiere të muzikes bashkëkohore, por nuk rezulton të ketë mbështetje direkte financiare. Ato mbështeten me dhënien e te drejtës për të përdorur sallat për koncerte apo veprimtari si dhe për logjistikën e veprimtarive.		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se përfshirja e studentëve në veprimtarinë artistike (koncerte apo evente koncertale) mobilitetet e tyre të realizuara në universitete homologe jashtë vendit janë një aspekt i rëndësishëm që garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në rregulloren e studimit Master I Arteve janë të përcaktuara të gjitha procedurat lidhur me detyrimet përmblyëse, si dhe dhënies së diplomës. Këto rregullore janë të publikuara në faqën zyrtare të UART-së.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblyëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit UART të rregulloreve të studimit, konfirmohet se janë të përcaktuara qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tërë strukturave si akademike dhe administrative për të mbështetur studentët me informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme që lidhen me detyrimet mbyllëse apo diplomimin. Në planin mësimor të programit është planifikuar në semestrin e fundit edhe një takim i përjavshëm 2 orësh në auditor për të ndjekur ecurinë e punës së studentit dhe për ta ndihmuar atë, gjë e cila u konfirmua edhe nga studentët gjatë takimit. Po kështu rezulton se në faqen zyrtare të UART-së në rubrikën “Trasparenca” tek procedura informimi dhe ankimim, studenti mund të marrë informacion apo të bëjë kërkesë për të marrë çfarë i nevojitet.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/	Ne rregulloren e programit të studimit Master i Arteve publikuar në faqen zyrtare te universitetit, rezulton se janë të pasqyruara tërë procedurat e punimit dhe të mbrojtjen e diplomës para një komisioni, i cili përbëhet nga pedagog me tituj nga departamenti dhe që bëhet publikisht.


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëmb site: www.ascal.al

<p>modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Edhe nga deklaratimet e studentëve konfirmohet se diplomimi përmban interpretimin e një pjese muzikore dhe mikrotezën një studim lidhur me pjesën që ka interpretuar. Drejtuesit e fakultetit dhe studentët deklaruan se komisioni i ngritur për diplomimin merr në konsideratë tërë ecurinë dhe rezultatet e tyre gjatë dy viteve. Kjo u dokumentua edhe me verifikimin e procesverbalit të provimit të diplomimit pranë sekretarisë mësimore.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në rregulloren e studimit të programit Master i Arteve janë të përcaktuara qartë detyrat e udhëheqësit të diplomës për studentët, grafikun e konsultimeve, afatet e realizimit të punimit, dhe garancinë për cilësinë e punimit. Konstatohet në planin mësimor në semestrin e katërt janë dy orë në javë në auditor që udhëheqësi i përdorte për të kontrolluar ecurinë e punës të studentit dhe për të dhënë udhëzime për përmisim. Në rregullore është përcaktuar edhe detyrimi i njësisë bazë për të kontrolluar ecurinë e kësaj pune. Departamenti disponon dokumente ku mund të verifikohen këto kontrole periodike që ka bërë kjo njësi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për vetë natyrën e institucionit ky kriter nuk zbatohet.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në rregulloren e studimeve të programit Master i Arteve , vlerësimi i punimit të diplomës, jepen procedurat e vlerësimit të studentit në punimin e diplomës i ngritur dhe miratuar nga Dekani i Fakultetit. Rezulton se vlerësimi bëhet me pikë nga secili anëtarë i komisionit dhe mesatarizimin e pikëve e ben kryetari i komisionit, duke bërë edhe konvertimin e tyre në notë.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Rezulton nga dokumentacioni i verifikuar në sekretarinë mësimore se studenti pajiset pas përfundimit të detyrimeve mbyllëse me diplomë dhe suplementin e saj. Nga verifikimi i diplomës rezulton se diploma ka të gjitha elementët e përcaktuar nga MAS dhe rregullorja e studimit e njësisë kryesore.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë mësimore rezulton se në përputhje me ligjin Nr 9887, date 10.03.2008, për mbrojtjen e të dhënave personale , kjo njësi ndihmëse administrative ka dhe ruan për cdo student dokumentacionin përkatës që nga rregjistrimi dhe deri në diplomimin e tij, duke e vënë në dispozicion të tyre sa herë I kërkohet.</p>

Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni zbaton procedure të qarta lidhur me detyrimet permbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfuturisë të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Programi i studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" është master shkencor, por duke patur praktikë artistike dhe profesionale (parashikuar në Planin mësimor), konfirmohet nga vizita në institucion se zbatohen të gjitha procedurat dhe krijohen të gjitha kushtet si me ambiente ashtu edhe me logjistikë për realizimin e tyre.		
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Është master shkencor ndaj ky kriter nuk zbatohet.		
Kriteri 3. Praktikatat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalenohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Për vetë natyrën e këtij masteri i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" ka të planifikuar praktikën për mësimdhënie e cila realizohet në tre javë në shkollë, dhe është vlerësuar me 6 ECTS		
Konkluzione	<i>Programi i studimit që vlerësohet është "Master i Arteve" dhe jo Master Profesional. Ndaj ky standard nuk aplikohet për këtë program studimi</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Ëcëb site: www.ascal.al

 35




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**


Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” të ofruar nga Departamenti i Interpretimit (DI) në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve, grupi i RVJ-së konstatoi se personeli akademik efektiv dhe me kontratë dhe personeli ndihmës akademik që angazhohen në këtë program, përmbush kërkesat ligjore për sa i përket nivelit të kualifikimit akademik të stafit, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Në lidhje me këtë program studimi, fusha kërkimore bazohet në specifikat e moduleve dhe përcaktohet në këto dokumente: Rregullorja e Studimit të Ciklit të Dytë të Studimeve dhe Statuti i UART.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji 80/2015 “Per Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Dokumenti I.I.I.I.1. - Udhëzim Nr. 29, datë 10.09.2018 “Per veprimtarine dhe ngarkesen mesimore te personelit akademik ne IAL”. Evidenca IV.1.1.2. - VKM, Nr. 145, datë 10.03.2021 “Per dhenien e statusit të vecantë të Universitetit te Arteve”, Evidenca I.I.I.I.1. - Statuti i UART, Evidenca I.I.I.2.1. - Rregullore e Programeve të Ciklit të Dytë, Master në Arte “Klarinetë dhe Mësuesi”, Evidenca 3.
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga evidencat e paraqitura nga DI qartësohet se për realizimin e ngarkesës mësimore për programin e studimit Master në “Klarinetë dhe Mësuesi”, angazhohet personel efektiv i brendshëm (10 pedagogë) dhe 3 pedagogë PAK (të jashtëm) për plotësimin e ngarkesës mësimore dhe është në përputhje me bazën ligjore në fuqi, Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018, Kreu II, Pika 1, 2, 6, 7, 10, 12 dhe pasohet në Evidencën IV.1.1.8.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tabela 6.3 dhe Tabela 7, Evidenca IV.1.1.8.

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Raporti i RVB-së për këtë program studimi theksonte se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mesuesi” ka nënshkruar kontratat me UART sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Dhe UART paguan rregullisht të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore shëndetësore të stafit akademik.</p> <p>Grupi i RVJ-së pasi shqyrtoi dokumentet e paraqitura nga përfaqësueset e BNJ të FM, konstatoi se në dosjen e paraqitur, ndër të tjera, ishin të përfshira një model marrëveshje për kohën e punës vjetore të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe një Kontrate punësimi të një anëtarë të DI, të cilat vertetonin qëndrueshmërinë e personelit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i UART, Evidenca I.I.1.2.1
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga RVB-ja rezulton se në DI, ku ofrohet programi i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” ndiqen procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Kriteret e përgjithshme hartoheshin nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ndërsa ato specifike nga Njësia bazë DI. Të gjitha procedurat për rekrutimin e stafit bëheshin konform rregullores dhe shpalleshin publikisht duke përfshirë dhe kandidatin fitues.</p> <p>Nga takimet e zhvilluara gjatë vizitave në institucion, por dhe nga Raporti vjetor i UART për vitin akademik 2020-2021, DI ka rekrutuar 5 pedagogë të rinj me kohë të plotë, ndërsa pedagog për Klarinetë nuk ka patur nevojë të rekrutojë sespe ka personel të mjaftueshëm.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i UART, Neni 56 dhe 57. Evidenca I.I.1.2.1. - Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore, Artistike-Kërkimore-Shkencore dhe Financiare. Viti akademik 2020- 2021, fq. 31. http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Grupi i ekspertëve gjatë vizitës në institucion nga bisedat me përfaqësues të DI-së konstatoi se për vetë specifikat që ka Fakulteti i Muzikës dhe DI, si laboratorë konsideroheshin mjediset që përdoroheshin për lëndë individuale ose në grup, ndërsa si laborator standard konsiderohej Laboratori i Audios. UART përcaktonte angazhimin e stafit ndihmës mësimor akademik, si pjesë e njësisë bazë të tij, të mbështetur në Statutin e UART. Funkcionet institucionale të stafit</p>

	<p>ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike, përcaktoheshin edhe në Rregulloren e FM.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i UART, Neni 69, pika 2 dhe 3. Evidenca I.I.1.2.1. - Rregullore e veprimtarise se pergjithshme dhe asaj mesimore e Fakultetit te Muzikes, Neni 7. Evidenca I.I.3.1.12.
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe perditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>U evidentua se Universiteti i Arteve mbledh, ruan dhe perditëson çdo vit akademik te dhenat e personelit te angazhuar ne programin e studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” duke u mbështetur në Statutin e UART (Neni 61, Pika 1, 2). Drejtorja e Burimeve njerëzore na ofroi dosjet e personelit akademik dhe konstatuam se kjo njësi i ruante të gjithë dokumentacionet si të stafit të brendshëm akademik ashtu edhe atij ndihmës dhe administrativ.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga analiza e evidencave të dorëzuara nga institucioni në sistemin AMS, grupi i RVJ-së evidentoi se Universiteti i Arteve, FM kishte lidhur marrëveshje me ZVA Tiranë dhe Vlorë për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve. Në këtë dokument, përcaktohen detyrimet e FM dhe Njësia bazë cakton një pedagog udhëheqës për të ndjekur praktikën profesionale të studentëve. Po ashtu, në Nenin 28 të Rregullores së programit të studimit Master në Arte “Klarinetë dhe Mësuesi” përcaktohet qartë mënyra e vendosjes së personelit të kualifikuar për udhëheqjen e praktikës mësimore.</p> <p>Ndërsa në lidhje me udhëheqjen e punimeve të diplomave dhe veprimtarive të tjera specifike sipas programit të studimit, edhe kjo detyrë përcaktohej në Rregulloren e programit të studimit, Neni 29, Pika 4.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshja e FM dhe ZVA Vlorë, Evidenca I.I.3.3.2. - Rregullore e Programeve të Ciklit të Dytë, Master në Arte “Klarinetë dhe Mësuesi”, Neni 28. Evidenca 3.
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>RVJ, në lidhje me plotësimin e kriterit 8, shprehet se detyrimet e angazhimit të personelit pritës të studentëve për realizimin e praktikave profesionale ishin të përcaktuara në akt marrëveshjen e lidhur ndërmjet UART dhe ZVA Vlorë dhe ZVA Tiranë. Në këtë marrëveshje, institucioni pritës merrte përsipër:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mundësimin e zhvillimit të praktikave në këtë shkollë; - caktimin e një mësues mentor të studentit praktikant; - vënien në dispozicion të studentëve materiale dhe mjete ndihmëse;



 38

	- angazhimin e studentëve praktikantë sipas nevojave që i paraqitej institucionit; dhënien e mendimeve për vlerësimin e punës së studentëve.		
Konkluzione	Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, qartësisht të pasqyruara, GVJ, konstaton se, personeli akademik efektiv dhe me kontratë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit. Konstatohet gjithashtu, se Drejtoria e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik, si dhe se departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program Konstatohet se realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës. Raporti i lektorëve të jashtëm me numrin e lektorëve efektivë, është i nevojshëm të përmirësohet, bazuar në legjislacionin në fuqi. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi IV,2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se mjediset për zhvillimin e veprimtarive mësimore ishin të përshtatshme. Për vetë specifikën e zhvillimit të procesit mësimor në këtë fakultet dhe program studimi, mësimi i vegël muzikore zhvillohej një pedagog - një student. Fakulteti i Muzikës vinte në dispozicion gjithë kapacitetet infrastrukturorë në funksion të plotë të krijimit të kushteve të duhura si për lëndët muzikore-artistike, ashtu edhe për lëndët pedagogjike.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion prej Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës, rezultoi se për vetë specifikën që kishte programi i studimit Master "Klarinetë dhe Mësuesi", lëndët individuale nuk kishin nevojë për mjedise me pajisje elektronike dhe TIK. Ndërsa për lëndët kolektive vihej në dispozicion Lektoriumi "Tonin Harapi", i cili ishte i pajisur me pajisje të TIK-ut. Referencë: - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve "Klarinetë dhe Mësuesi", Evidenca 1.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas	Nga bisedat e zhvilluara me anëtarët e DI, konstatohet se Studiot e Interpretimit ishin të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëëb site: www.ascal.al

39

<p>natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>për realizimin me sukses të kurrikulës së programit të studimit "Klarinetë dhe Mësuesi".</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Konstatohet se Fakulteti i Muzikës zotëron në mjediset e tij dy laboratorë të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale. Nga vizita në institucion dhe sipas dokumentacionit të dorëzuar nga UART, FM dhe DI, na u siguroa se kompjuterat e laboratorit nr. 1 janë të pajisur me programin profesional Sibelius (për notizim digjital) dhe Steingerg Cubase (për regjistrim dhe përpunim audio) kurse Laborator i Tingullit ishte një studio e mirëfilltë ku realizohej regjistrimi dhe përpunimi audio.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve "Klarinetë dhe Mësuesi", Evidenca 1. 		
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Konstatohet se Fakulteti i Muzikës garanton zhvillimin e praktikave artistike në mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Këto praktika materializoheshin në realizimin e koncerteve, ku interpretoheshin vepra kombëtare ose ndërkombëtare me studentë të Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi".</p> <p>Ndërsa për zhvillimin e praktikave profesionale ato realizoheshin në mjediset e institucioneve të arsimit parauniversitar ku FM kishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione (Marrëveshja me ZVA Tiranë dhe Vlorë).</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve "Klarinetë dhe Mësuesi", Evidenca 1. 		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe asaj artistike. Gjithashtu, konstatohet se institucioni, ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p><input type="checkbox"/></p>	<p><input type="checkbox"/></p>	<p><input checked="" type="checkbox"/></p>



Standardi IV.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Ëeb site: www.ascal.al

40

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Fakulteti i Muzikës, konstatohet që literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve Klarinetistë në gjuhën shqipe (fizike dhe/ose digjitale për Modulin A, C) dhe në gjuhën universale të muzikës (fizike dhe digjitale për Modulin B) përmes Syllabuseve të Planit Mësimor të Programit të Studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme. Literatura Bazë dhe ndihmëse ofrohet dhe gjendet fizikisht në formë tekstesh dhe partiturash pranë Bibliotekës së UART ose fizikisht në formë leksionesh nga pedagogët e lëndëve; dhe në menyrë digjitale përmes lidhjeve të faqeve të internetit që mund të aksesoheshin.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Klarinetë dhe Mësuesi”, Evidenca 1.
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DI , ku ofrohet Programi i Studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”, konstatohet që bëheshin përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. Nga bisedat me pedagogët e këtij program studimi u evidentua se përditësimi i literatures realizohej edhe nga botimet e partiturave muzikore mbi bazen e dorëshkrimit original, përshtatjeve të materialeve të ndryshme muzikore për veglën Klarinetë si dhe duke marrë parasysh edhe veçoritë individuale të studentëve Klarinetistë.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Klarinetë dhe Mësuesi”, Evidenca 1.
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në Institucion u konstatua se Biblioteka Shkencore e UART garantonte mundësi të barabarta shfrytëzimi të fondit të saj për të gjithë studentët e Universitetit të Arteve, përfshirë këtu edhe studentët Klarinetistë përmes (a) hapjes së një karteje anëtaresimi në BSHUA apo (b) hapjes së një llogarie online për Arkivin digjital të BSHUA.</p> <p>Biblioteka kishte dy salla që viheshin në dispozicion të studentëve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Salla e leximit me një kapacitet prej 30 vendesh dhe tre kompjuterash. 2. Salla multimediale me një kapacitet prej 20 vendesh dhe 20 kompjutersh për secilin vend. <p>Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Shkencore në UART përcaktohet në rregulloren e saj të miraturuar nga Senati Akademik.</p> <p>Referencë:</p>



	-Statuti i UART, Neni 21, Pika 4. Evidenca I.L.1.2.1
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Informacioni lidhur me bibliotekën e UART, na u përcoll nga drejtoresha e saj, punonjëse në këtë bibliotekë që prej 34 vitesh. Sipas këtij informacioni dhe vizitës në mjediset e brendshme të bibliotekës, deklarojmë se Biblioteka e UART është biblioteka e vetme e Artit që ekziston në Shqipëri. Biblioteka kishte një histori prej 60 vitesh, që nga themelimi i Fakultetit të Muzikës, gjatë të cilave ajo kishte pasuruar fondin e saj me dorëshkrime shumë të vyera, disqe, kasete, libra, punime diplomash, etj., të cilat ishin edhe në proces të dixhitalizimit për t'ju vënë në dispozicion të të gjithë të interesuarve. Fondi i saj i mbyllur dhe ai i hapur, fizik dhe elektronik, ofronte për të gjithë studentët e UART dhe për studentët Klarinetistë, një fond jashtëzakonisht të pasur shqip dhe në gjuhë të huaj, me tekste, parte e partitura për zhvillimin e veprimtarive mësimore sipas natyrës dhe specifikës së programit të studimit "Klarinetë dhe Mësuesi".
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Fakulteti i Muzikës dhe Biblioteka e UART ofronin mundësi të shfrytëzimit të literaturës online pa pagesë për të gjithë studentët. Ata kishin mundësi të aksesoheshin në arkivën digjitale të BSHUA dhe për vetë specifikat e programit të studimit "Klarinetë dhe Mësuesi", të merrnin shërbime pa pagesë në IMSLP - PETRUCCI MUSIC LIBRARY. Referencë: - Katalogu online i BSHUA: http://www.uart.edu.al/index.php?page=faqe&id=344&niveli=60 . - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve "Klarinetë dhe Mësuesi", Evidenca 1. - MSLP- PETRUCCI MUSIC LIBRARY: https://imslp.org/eiki/Main.Page .
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizita e zhvilluar në Bibliotekën e Universiteti të Arteve, konstatuam se BSHUA kishte përveç sallës së leximit, edhe sallën multimediale, e cila ishte e pajisur me 20 kompjuter të vënë në dispozicion të studentëve të saj. Kompjuterët ishin të pajisur me programe kompjuterike (office, adobe premier, finale) dhe pajisje teknike si kufie, printer dhe scanner. Këto pajisje mundësonin jo vetëm leximin e veprës muzikore por edhe dëgjimin e interpretimit të muzikës nga të gjithë studentët e FM.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga vizita në institucion evidentohet se Biblioteka kishtë të afishuar në një vend të dukshëm të saj oraret e shërbimeve sipas nevojave të studentëve. Këto orare përfshinin ditët gjatë zhvillimit të procesit mësimor (e hënë - e enjte: 08:00-19.00; e premte 08.00-16:00) ashtu edhe periudhat e sesioneve të provimeve, në të cilën biblioteka qëndronte e hapur më një orar më të zgjatur.


<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, konstatohet se Biblioteka e Universitetit të Arteve, Fakulteti i Muzikës si dhe Departamenti i Interpretimit ndjekin dhe raportojnë periodikisht për cilësinë e fondit fizik dhe atij online të bibliotekës, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit nga personeli akademik dhe studentët, për kërkesat për tituj të rinj nga ana e DI, si dhe për performancën e personelit akademik, përmes komunikimeve zyrtare.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Klarinetë dhe Mësuesi”, Evidenca 1. 		
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se, Biblioteka e UART ka një fond shumë të pasur fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj si dhe dorëshkrime, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës të programit të studimit, por vërehet një mungesë fondi dedikuar kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ofrohen në të gjitha programet e ciklit të dytë të studimeve që ofrohen në këtë institucion, si rrjedhojë: Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktiviteteve akademike, financiare e administrative për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të FM, konstatohet se Universiteti i Arteve disponon një sistem menaxhimi, nëpërmjet të cilit, administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Muzikës dhe specialistes për sistemin PITAGORA - Sektorit mesimor, të Kurrikulave dhe Informimit të studenteve, - Drejtoria e BNJ dhe Informacionit, Protokollit dhe Arkivës - Sektorit të Statistikes - Sektorit të IT




	<ul style="list-style-type: none"> - Komisionit të Marrëdhënieve me Studentet (Statuti UART Neni 30/d, Neni 34). <p>Ndërsa përsa i përket menaxhimit elektronik të informacionit, ai realizohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqja zyrtare e UART ne internet dhe rrjetet sociale http://www.uart.edu.al - Komunikimi permes postës zyrtare email - Sistemit PITAGORA - Platformës online TEAMS. <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Klarinetë dhe Mësuesi”, Evidenca 1.
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, u konstatua se UART, e mbështeste sistemin e brendshëm të menaxhimit në Statutin e saj dhe e administronte informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, personelin administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në programin e studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”, përmes:</p> <p>a) përditësimit të të dhënave të dosjes individuale, CV dhe dokumentacionit shoqërues;</p> <p>perditësimit te te dhenave te aktivitetit akademik, kërkues artistik (akt marreveshja per kohen vjetore të punes me dokumente mbeshtetes), të veprimtarisë ndihmëse akademike me karakter mësimor, artistik, shkencor, etj.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Klarinetë dhe Mësuesi”, Evidenca 1. - -Statuti i UART, Neni 78. Evidenca II.1.2.1
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, konstatohet se, Sistemi i menaxhimit të brendshëm të UART dhe FM, ku ofrohet programi i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”, siguron mundësi të posaçme në informacione e dokumente si për personelin akademik, ashtu edhe për studentët, duke vënë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqen zyrtare të UART, për njoftimet, informacionet mbi studentet, ambientet, aktivitetet, marreveshjet, organet drejtuese, personelin akademik, njoftimet për punësim, për projektet si dhe mbi fakultetet e UART dhe Bibliotekën Shkencore te UART. - Sistemin PITAGORA të regjistrimit të të dhënave të studentëve për frekuentimin, regjistrimin në provimet, mënyrës së vlerësimit, paraqitjen e notave dhe gjenerimin e proces-verbaleve të provimeve dhe në veçanti për studentët, marrjen e vlerësimit në kohe reale dhe ngarkimin e rezultatit në librezën e studentit.


	<p>Shkëmbimit të e-maileve me Sektorin mesimor; të Kurrikulave dhe Informimit të studentëve; Drejtorinë e BNJ dhe Informacionit, Protokollit dhe Arkivës; me Sektorin e Statistikës dhe IT-së.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informacion zyrtar në faqen eeb të Universitetit të Arteve. Evidenca I.I.2.2.3
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga vizita në UART dhe nga logimi në faqen zyrtare të tij, konstatohet se Institucioni ka integruar platformën PITAGORA dhe TEAMS që u mundëson personelit dhe studentëve forma të komunikimit interaktiv dhe të shkëmbimit të informacionit.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, konstatohet se Sistemi i menaxhimit i UART në FM dhe DI, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ përmes firmosjes fizike të listë prezencës së personelit akademik, çdo ditë pune pranë Sekretarisë mesimore.</p> <p>Ndërsa në lidhje me raportimet individuale dhe të dhënat në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese, ky monitorim realizohet përmes verifikimit të veprimtarisë akademike e administrative të personelit të UART dhe gjenerimit të raporteve në kohë reale, si përmes kontrolleve të organizuara nga organet dhe autoritetet drejtuese, ashtu edhe nepermjet raportit të përdorimit të platformës TEAMS (në rastin e periudhës Covid -19).</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve "Klarinetë dhe Mësuesi", Evidenca 1.
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga logimi në faqen zyrtare të UART, konstatohet se Institucioni në faqen e tij zyrtare http://uart.edu.al/ paraqet të gjithë informacionin lidhur me këtë institucion. Informacionet publikohen nga Sistemi i menaxhimit të brendshëm në dy gjuhë ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. Informacionet kryesore lidhur me strukturën e organizimit të UART, publikohen edhe në gjuhën angleze.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet sistemit PITAGORA, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatohet, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të eeb-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>

	Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, Raporti financiar i kostove të njësisë bazë të Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve, së bashku me mbështetjen e nevojshme financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit (për të paktën një cikël të plotë studimi), përfshihet në parashikimet e Projekt buxhetit afatmesëm dhe në parashikimin e përvitshëm për financimin e të gjitha programeve të kësaj njësie.</p> <p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar, burimet financiare të Njësisë Bazë DI, përlogariteshin nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Buxheti i Shtetit (Granti i Politikave të Zhvillimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë; Grandi i mësimdhënies dhe Granti i Punës Kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese), dhe <p>Të ardhurat e krijuara nga institucioni.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - RVB e Programit “Klarinetë dhe Mësuesi”, Evidenca 1
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani financiar hartohet në nivel institucional dhe nuk ka një raport të posaçëm për programin e studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në VKM nr. 83, datë 3.2.2016, Universiteti i Arteve nuk i plotëson kushtet për kryerjen e auditimit periodik nga vetë Institucioni për shkak të mos plotësimit të kriterëve të parashikuara: <i>“që shpenzojnë fonde publike sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, të cilat kanë në vit, njëkohësisht jo më pak se 400 000 000 (katërqind milionë) lekë të ardhura financiare dhe 300 punonjës, përgjatë 3 (tri) viteve të fundit të veprimtarisë së tyre”</i>.</p> <p>Universiteti i Arteve mund të auditohet periodikisht sipas akteve ligjore në fuqi nga Institucione eprore dhe të specializuara. Sipas dokumentacionit të dorëzuar, UART nga viti akademik 2019 -2020 e deri më tani, nuk i është nënshtruar ndonjë procesi auditimi.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr. 83, datë 3.2.2016. Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik. fq. 2050 të Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 19, fq. 2050. https://shukalb.al/ep-content/uploads/2019/07/VKM-Nr.-83-3.2.2016 - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Klarinetë dhe Mësuesi”, Evidenca 1.
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Fakulteti i Muzikës, DI, konstatohet se UART e realizon kriterin e raportimit tek Njësia bazë që është DI, në lidhje me realizimin e buxhetit të miratuar të vitit pasardhës për programin e studimit “Klarinetë dhe Mësuesi”, bazuar në Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”.</p> <p>Po sipas dokumentacionit të dorëzuar, UART për çdo vit shkruan Raportin Vjetor i cili ndër të tjera përmban edhe analizën financiare. Analiza financiare ju bëhet me dije Njësive Bazë edhe për arsye rakordimi me parashikimet e vitit pasardhës. Raporti vjetor miratohej në një mbledhje të përbashkët të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit të UART dhe i dërgohen Ministrise së Arsimit dhe Sportit.</p> <p>Referencë:</p> <p>https://fdut.edu.al/ep-content/uploads/2021/09/63. http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për</p>	<p>Universiteti i Arteve garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë, Departamentit të Interpretimit dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, bazuar në:</p>

<p>ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ligjin nr. 80/2015 Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor; - Ligjin nr. 10/296, date 08.07.2010 Per menaxhimin financiar dhe kontrollin; - Statutin e UART. <p>Garancia për qëndrueshmërinë financiare sigurohej përmes parashikimeve të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - raportit financiar të kostove të njësisë bazë, DI të Fakultetit të Muzikës, përgjegjëse për programin e studimit Master i Arteve “Klarinetë dhe Mësuesi” dhe, - Projekt buxhetit afatmesem, <p>përvitshme për financimin e të gjitha programeve të studimit pranë kësaj njësie.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve “Klarinetë dhe Mësuesi”, Evidenca 1.
--	--


Konkluzione

Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. GVJ gjatë vizitës ka sygjerruar se duhet të ketë mbështetje më të madhe financiare për veprimtari dhe aktivitete artistike sidomos për aktivitete ndërkombëtare

Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.


Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X






V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE



Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimit, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Univeristeti i Arteve, harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë të studimeve, në rastin konkret, programet e nivelit të dytë të studimit, specifikisht Master i Arteve ‘Klarinetë dhe Mësuesi’.</p> <p>Fakulteti i Muzikës, në Universitetin e Arteve, e zhvillon veprimtarinë e tij, bazuar në ‘Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithëshme dhe asaj Mësimore, Të fakultetit të Muzikës’ si dhe në Rregulloren e Përgjithëshme të Universitetit’.</p> <p>Bazuar në ‘Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithëshme dhe asaj Mësimore, Të fakultetit të Muzikës’, e miratuar në datën 07/12/2021, nr.36, mbështetur në ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionin e arsimit të lartë, i miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve. Neni 27 paraqet kriteret dhe procedurat e pranimit në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, në programet Master Shkencor, Master i Arteve dhe Master Profesional. Kjo rregullore paraqet në nenin 28, regjistrimin e studentëve në ciklin e dytë të programeve të masterit të Arteve, Master Shkencor dhe Master professional.</p> <p>Rregullorja paraqet qartë, kushtet dhe procedurat e transferimit (Neni 30 dhe 31), mbarëvajtjen dhe mësimdhënien (Neni 32, 33 dhe 37), frekuentimin (Neni 36) etj.</p> <p>Një element i rëndësishëm për tu përmendur, është edhe qartësia e rregullores bazuar në statusin e vençantë që Universiteti i Arteve e gëzon aktualisht. Këtë e paraqet në mënyrën e kontrollit të dijes dhe njohurive, mbarëvajtjen e sistemit të provimeve dhe vlerësimit, që gjenden në Kreun 5, Kontrolli i Njohurive dhe Sistemit të Vlerësimit (Neni 41 -52).</p> <p>Gjithashtu, Programi i ciklit të dytë, Master i Arteve ‘Klarinetë dhe Mësuesi’, zbaton rregulloren e programeve të ciklit të dytë, të miratuar me vendim Senati Akademik, Nr 36 datë 13/09/2022, cila përmban detaje rreth objektivave, qëllimit të studimit, formës së matjes së njohurive, sezonet e provimeve, praktikat profesionale, diplomimin etj.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - -Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” - Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë



<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e Universitetit të Arteve (të cilat janë realizuar duke u mbështetur në ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve, ku një pjesë e saj në kreun 6, i dedikohet te drejtave dhe detyrimeve të studentit, që përfshihet statusi i tij, etika dhe sjellja. Politikat e strategjive që gjenden në Plani Strategjik 2018-2025, dhe rregulloret e Universitetit dhe programit të ciklit të dytë, paraqesin garantim të barazisë dhe të drejta të barabarta për të gjithë studentët.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i Universitetit të Arteve,, Kreu 6, Të drejtat dhe detyrimet e studentit, http://www.uart.edu.al/media/Statuti_uart_2021.PDF - Statuti i Universitetit të Arteve,, Kreu, Etika dhe Sjellja, http://www.uart.edu.al/media/Statuti_uart_2021.PDF - Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni, paraqet transparencë komunikimi të zyrtarizuar për studentët edhe në faqen zyrtare (http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=9&niveli=66)</p> <p>Vihet re, që profili i universitetit është centralizuar me fokus studentët. Kjo dallohet te rubrika e faqes zyrtare, ku përparësi kanë studentët, në listuar të parët në ofrimin e shërbimeve.</p> <p>Platforma paraqet njoftime të përditësuara me fokus studentët (e ardhshëm, aktual dhe alumni) rreth kritereve të pranimit, të përfitimit të bursave si dhe veprimtarive të ndryshme që realizohen në këtë institucion http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=9&niveli=66</p> <p>Konstatohet se në faqen zyrtare jepet informacioni i përgjithshëm për Universitetin e Arteve, Departamentin e Interpretimit, programet e studimit të ciklit të dytë dhe të parë, si dhe informacione për stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nëpërmjet platformës online, si dhe informimet nga zyrat përkatëse, të gjithë maturantët ose aplikuesit e interesuar, informohen për procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes (duhet marrë në konsideratë profilin e arteve që ky institucion i përket). Gjithashtu, në rregulloren e programeve të ciklit të dytë, paraqitet qartë transferimet e studimit, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit.</p> <p>Nga vizita në institucion, konstatohet se rregulloret janë të printuara dhe të afishuara në ambientet fizike të institucionit, ku studentët kanë akses të lehtë siç është sekretaria mësimore.</p>





	<p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqja Zyrtare online e Universiteti të Arteve, (http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=9&niveli=66) - Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë Master në Arte
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Platforma online, përmban sesionin e njoftimeve, ku institucioni informon publikun dhe të gjithë të interesuarit në lidhje me kriteret e përgjithëshme dhe të veçanta (specifikisht kurrikulat dhe shpërndarjen e ngarkesës së çdo lende, të ndarë në semestra), të çdo program studimi, specifikisht të program Master i Arteve ‘Klarinetë dhe Mësuesi’.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Interpretimit ,Faqja Zyrtare online e Universiteti të Arteve, http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=193&niveli=70
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Universiteti i Arteve, pavarësisht se gëzon statusin e veçantë, bazohet në kriteret e përgjithshme që janë të përcaktuar nga dispozitat ligjore të arsimit të lartë dhe aktet nënligjore të ndërtuara nga Ministria e Arsimit, për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta dhe ndryshe, të pakicave dhe grupeve të marginalizuara.</p> <p>Konstatohet se ky institucion me profil tërësisht në art, ka specifikë në përzgjedhjen e studentëve të cilët janë të talentuar në profilet ku ata aplikojnë. Studentët e programit të studimit Master i Arteve, kanë edhe disa kriteret specifikë, specifikë të Departamentit, të cilat kanë lidhje me interpretimin e instrumentave, specifikisht Klarinetë. Në procesin e pranimit studentët njihen edhe me natyrën praktike të studimit që ata kanë përzgjedhur. Politikat dhe strategjitë që Universiteti i Arteve harton dhe zbaton janë sa specifikë aq edhe të përgjithëshme (bazohen në aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit, për grupet e veçanta)</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani strategjik i Universitetit të Arteve, 2018-2025 - Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Universiteti i Arteve, pavarësisht se gëzon statusin e veçantë, bazohet në kriteret e përgjithshme që janë të përcaktuar nga aktet nënligjore të ndërtuara nga Ministria e Arsimit, për përzgjedhjen e kandidatëve nga trevat dhe shtetet e ndryshme.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Universiteti i Arteve, me statusin e tij të veçantë, duke qenë institucion me profil tërësisht në art dhe i financuar prej ministrisë së arsimit, ka qëllim përthithjen dhe promovimin e talenteve në gjithë vendin tonë, nga trevat dhe rajoni (sias kuotave të përcaktuara), si dhe nga vendet e tjera.</p>





	<p>Niveli i lartë i rezultateve të tyre, si nga mesatarja e shkollave të mesme, qoftë nga rezultatet e larta të përfituara në vitin e parë akademik, u mundëson të gëzojnë të drejtën e bursave. Hartimin e politikave të bursave, insitucioni e ka në përputhshmëri me -ligjin e arsimit të lartë. Konstatohet se, në planin strategjik 2018-2025, strategjia për studentët, politikat e përzgjedhjes dhe inkurajimit të talenteve është përparësi për këtë institucion. Kjo tregon strategjinë e përthithjes së studentëve të talentuar, të cilët të kenë impakt në rritjen e cilësisë së artit dhe edukimit të artit në vendin tonë.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani strategjik I Universitetit të Arteve, 2018-2025 - Statuti i Universitetit të Arteve, Evidenca I.I.1.2.1Neni 93/1 http://www.uart.edu.al/media/Statuti_uart_2021.PDF - VKM 145, datë 10.03.2021: Për dhënien e statusit të veçantë për Universitetin e Arteve, Pika 8/a http://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/03/10/145 								
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacion si dhe në vlerësimin prej takimit në institucion vlerëson se, kriteri V.1, përmbushet plotësisht nga Universiteti i Arteve, i cili harton, ndjek dhe zbaton politika dhe strategji pranimi të përsgjedhjes pranimit, transferimit, vlerësimit të dijeve, në përputhje të plotë me statutin, rregulloren e institucionit, rregulloren e studimit dhe përputhshmërinë legjislative.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mb përparimin akademik, njihjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Rregullore e ciklit të dytë të studimeve, specifikisht Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi', disponojnë informacion të qartë dhe të plotë për studentët rreth procedurave të përparimit të vitit akademik dhe detyrimet për të kaluar në një tjetër vit akademik.</p> <p>Gjithashtu, faqja zyrtare e Universitetit të Arteve, paraqet informacionin e duhur për studentët për kriteret, procedurat dhe datat (kalendarin akademik të vitit përkatës), orarin, e fillimit të studimeve në programin e Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi'. Gjithashtu, institucioni disponon informacionin në ambientet e përcaktuara, të njohimeve për secilin fakultet.</p> <p>Referencë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” - Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti I Interpretimit, , Universiteti i Arteve, 2021-2022.
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e ciklit të dytë të studimit, në Master i Arteve, ‘Klarinetë dhe Mësuesi’, në kreun e dytë, neni 11, pika 4 dhe 5, paraqet qartë informacionin për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme, por me përmbajtje të profilit të arteve, specifikisht në instrument.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”, Neni 11, Pika4-5.
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet rregullores, lajmërimeve në vendin e përcaktuar për lajmërimet në ambientet e çdo fakulteti përkatës, në syllabuset e lëndëve të prezantuar në auditor, dhe nëpërmjet lançimit të syllabuseve dhe mënyrës së vlerësimit në faqen zyrtare online, i informon studentët për procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive që do të përvetësohen në lëndët që ata do të frekuentojnë.</p> <p>Institucioni e paraqet informacionin nëpërmjet disa lloje kanalesh komunikimi, si të afishuar, online dhe nëpërmjet stafit akademik.</p> <p>- Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Universiteti të Arteve - Njoftime, Faqja zyrtare online e Universitetit të Arteve, Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”, http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=604&niveli=132 - Syllabuset e programit të studimit Master në Arte Klarinetë dhe Mësuesi.
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve, në rregulloren e ciklit të dytë të programeve të studimit, specifikisht në Kreun 8, për diplomimin, përcakton qartë modalitetet e diplomimit, zgjedhjen dhe ndryshim e udhëheqësit, ndryshimin e temës së diplomës, përgatitjen dhe organizimin e mbrojtjes së diplomës (në dy forma, performancë artistike dhe veprimtari teorike të paraqitur me format të printuar), si dhe vlerësimin e saj. Kjo rregullore ndodhet e printuar në këndin e lajmërimeve të përcaktuara nga universiteti.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi”,Kreu 8
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon</p>	<p>Universiteti i Arteve mundëson ‘Java e Orientimit’ për të gjithë studentët e rinjë. Në këtë javë, stafi akademik dhe administrative, duke ndjekur</p>



<p>udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>një agjendë të përcaktuar më parë, informojnë studentët në vartësi të programeve të studimit ku ata janë të regjistruar. Kjo praktikë u mundëson atyre, njohjen me stafin akademik, me zyrat dhe funksionet e tyre si dhe formën e komunikimit zyrtar të institucionit (siç janë afishimi dhe lancimi i datave të provimeve, koncertet që zhvillohen, aktivitetet e ndryshme artistike etj).</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi", Kreu 8 						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se Universiteti Arteve, vë në dispozicion të plotë të studentëve të programit të studimit Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi', si dhe mundëson qarkullimin e informacionit të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit e tyre.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="550 728 917 795"></td> <td data-bbox="917 728 1117 795">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1117 728 1327 795">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td data-bbox="550 795 917 840"></td> <td data-bbox="917 795 1117 840"></td> <td data-bbox="1117 795 1327 840">X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Rregullore e ciklit të dytë të studimeve, specifikisht Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi', në kreun 1 dhe kreun 2, jep informacione të detajuara për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të nivelit të dytë të studimit.</p> <p>Ky informacion disponohet edhe nga zyra e studentit, si dhe nëpërmjet këshillimit me stafin akademik, përpara regjistrimit të studentit.</p> <p>Informacioni mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë Master në Arte - Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi", Kreu 1-2 - Faqja Zyrtare online e Universtit të Arteve, http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.PDF - Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë Master në Arte Neni 12/1/a
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për</p>	<p>Në faqen zyrtare online të universitetit, paraqitet programi i studimit me lëndët që ka çdo program. Lëndët janë të përcaktuar në secilin semestër, me ngarkesën përkatëse dhe kategorizimin e tyre.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al

54

<p>lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Ndërsa, syllabuset e lëndëve, që prezantohen nga stafik akademik që zhvillohen lëndët, japin informacion të plotë për studentin për mënyrën se si janë të specifikuara lëndët dhe modulet mësimore, dhe veprimtaritë formuese të tyre. Ato përshkruajnë, temat, ngarkesën javore, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, format e kontrollit të dijeve etj.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani Mësimor i Programit të Studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" http://uart.edu.al/media/master-flaut-oboe-klarinete-fagot-trombe-klarinetë-trombon-bastube-21-22.pdf
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë vizitës institucionale së GVJ-së në Universitetin e arteve, dhe takimin me studentët, ata shprehen pozitivisht dhe ndiheshin të mbështetur dhe të motivuar prej stafit akademik, të cilët u kishin mundësuar lidhjet me institucionet ku një pjesë e tyre aktualisht ishin të punësuar (specifikisht në orkestrën e ushtrisë).</p> <p>Tregues ky, që mundëson institucioni u jep mbështetje dhe orientim studentëve për tregun e punës.</p> <p>Gjithashtu, në rregulloren e studimeve të programeve të ciklit të dytë në Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi', Kreu 6, neni 37 paraqet specifikisht mundësitë e punësimit të studentëve në tregun e punës.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GJV-së në Universitetin e Arteve - Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi"
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Rregullore e Ciklit të dytë të studimeve, Master i Arteve në Klarinetë dhe Mësuesi, paraqet një kre të veçantë, për informimin e studentëve, që nëpërmjet këshillit të studentëve, vendosin në dispozicion urën e informimit të vazhdueshëm.</p> <p>Nga vizita e GVJ-së në institucion, konstatohet se stafi akademik duke kaluar shumë kohë në ambientet e institucionit, për punën akademike dhe për aktivitet artistike me studentët, kanë një komunikim të vazhdueshëm dhe të harmonizuar. Auditorët, përdoren nga studentët edhe stafi (shpeshherë së bashku), për shkak të aktiviteteve artistike por edhe të statusit të veçantë që ky universitet ka. Komunikimi u mundëson informacion të vazhdueshëm mbi oraret e lira të sallave dhe ambientet e përbashkëta për të punuar dhe praktikuar instrumentat që studentët përdorin.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në "Klarinetë dhe Mësuesi" - Vizita e GJV-së në Universitetin e Arteve





<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga vizita institucionale e GVJ-së, konstatohet se numri relativisht i vogël i studentëve, hap rrugën e një komunikimi më të lehtë dhe sistemi të menaxhimit për qarkullimin e informacionit të brendshëm. Kjo lehtëson komunikimin e informacionit dhe mënyrën e informimit.</p> <p>Lehtësia në arritjen e komunikimit realizohet nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Faqes zyrtare online të universitetit 2. Njoftimet e pedagogut për çdo lëndë. 3. Pikët individuale nga pedagogu për çdo student dhe çdo vlerësim në praktikimin e instrumentit. 4. Paraqitja në prova dhe praktikim të instrumentit. 5. Mundësi komunikimionline dhe offline mes studentëve dhe pedagogëve. 6. Mundësi komunikimi me telefonatë dhe mesazhe. 						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se, Universiteti i Arteve, përmbush plotësisht standardin V.3, për arsye se vendos në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit, të cilat janë plotësisht të aksesueshme edhe në faqen zyrtare online.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="544 909 922 981"></td> <td data-bbox="922 909 1126 981">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1126 909 1327 981">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td data-bbox="544 981 922 1023"></td> <td data-bbox="922 981 1126 1023"></td> <td data-bbox="1126 981 1327 1023">X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomimin, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Universitetin e Arteve, konstatohet se zyra e sekretarisë mesimore disponon të gjitha të dhënat e arritjeve akademike të studentëve, me regjistrat përkatës dhe dokumentacionin e arkivuar. Kjo zyrë disponon statistika të çdo viti akademik, por edhe të pesë viteve të fundit të programit të Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi'. Gjithashtu, duke qenë numri i vogël studentësh, punonjësit e zyrës i njihnin edhe personalisht të gjithë studentët e këtij program studimi.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së në Universitetin e Arteve Drejtoria BNJ, Informacion/Protokoll/Arkivë, http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=110&niveli=5
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së në zyrën e sekretarisë mesimore, në Universitetin e Arteve, konstatohet se informacioni rreth statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga program, largimet para diplomimit, ngrirjet e studimeve dhe përfundimi me sukses ose jo i programit të studimit, ishin të detajuara,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Është site: 



<p>programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>regjistruara dhe arkivuara. Universiteti i Arteve, nën njësinë e Burimeve Njerëzore, disponon zyrën e statistikave, për mbledhjen, përpunimin dhe arkivimin e statistikave.</p> <p>Referencë: -Vizita e GJV-së në Universitetin e Arteve</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve, në sekretarinë mësimore, në Universitetin e Arteve, menaxhohen përmes formave statistikore, regjistrave zyrtar dhe arkivimit në format të printuar dhe online, lehtësisht të verifikueshme nga personat të autorizuar nga vet institucioni duke marrë në konsideratë ligjin dhe ruajtjen e të dhënave personale. Mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale, Universiteti i Arteve, bazuar edhe në ligj, e ka kthyer në politikë primare të tij, e cila mund të gjendet në faqen zyrtare online, me titullin Privatësia.</p> <p>Gjatë vizitës së GJV-së në Universitetin e Arteve, u prezantua me zyrën mësimore, e cila disponon të dhënat zyrtare statistikore të pesë viteve të fundit të programit Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi'.</p> <p>Referencë: - Vizita e GJV-së në Universitetin e Arteve, Takimi me përfaqësues të Drejtorisë, BNP, Informacion/Protokoll/Arkivë</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Universiteti i Arteve, duke pasur një numër jo shumë të madh të studentëve dhe punonjësve, për shkak të specifikës së profilit të tij, politika e brendshme të kontrollit janë formale dhe informale. Me anë të ngritjes së grupi Ad Hoc, për sigurimin e cilësisë së institucionit. Universiteti i Arteve mundëson kontrollin dhe cilësinë e institucionit nëpërmjet këtij grupi, nëpërmjet monitorimit të sekretarisë mësimore, sistemin e brendshëm, ecurinë e departamentit, informacionet e brendshme të njësive përgjegjëse, vërtetësinë e dokumentave të brendshme dhe kontrollin e cilësisë brenda zyrave qendrore të institucionit.</p> <p>Referencë: - Vizita e GJV-së, në Universitetin e Arteve - Statuti I Universitetit të Arteve - NJSBC</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit i cili ofron programin Master i Arteve në 'Klarinetë dhe Mësuesi', njofton dekanatin nëpërmjet shkresave dhe raporteve rreth profilit të cilësisë së hyrjes dhe daljes së studentëve, duke ngritur grupe pune. Këto grupe pune, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore dhe me stafin akademik, paraqesin profilin e studentëve. Përtej hartimit të raporteve analitike, duke pasur një numër të ulët të studentëve, grupi i punës i njeh nga afër studentët dhe është i informuar për ecurinë e tyre.</p>

	Referencë:		
	<ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Drejtoria e BNJ dhe Informacion/Protokoll/Arkivë 		
Konkluzione	GVJ vlerëson se, Universiteti i Arteve, përmbush plotësisht standardin V.4, për arsye se ruan të dhëna të hollësishme (i mbledh, administron dhe përditëson), në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluesë, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Në statutin e Universitetit të Arteve, miratuar me vendimin e senatit akademik, nr.15, datë 30/08/2021, Kreu 1, Neni 23, pika 3, shkruhet se ‘Senati akademik i UART, përbëhet nga 19 anëtarë, 4 përfaqësues për çdo fakultet, 2 përfaqësues të studentëve, Rektori, Zëvendës rektori për anën mësimore dhe dekanët e fakulteteve automatikisht janë pjesë e Senatit Akademik.’ Kjo pikë është realizuar në përputhshmëri me aktet ligjore për arsimin e lartë.</p> <p>Gjithashtu në nenin 123, i Statutit të Universitetit, mbi Të drejtat e Studentëve, në pikën 1 dhe 2, e paraqet qartë përfaqësimin e studentëve në organet e UART si dhe të marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së institucionit, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i Universitetit të Arteve, Evidenca I.I.1.2.1Kreu 1, Neni 23/3 - Statuti i Universitetit të Arteve, Evidenca I.I.1.2.1Kreu1, Neni 123/1-2
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Studentët kanë të drejtë të jenë të përfaqësuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1-Senatin Akademik; 2-Këshillin e etikës; 3-Komisionet e përherëshme të lejuara më statut; 4-Këshillat e studentëve. <p>Këshilli i Studentëve është organ i cili zgjidhet çdo dy vjet me votat e studentëve dhe mbështeten nga legjislacioni në fuqi. Këshillat e Studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes në UART si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al

 58



	<p>veprimtarinë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Institucioni garanton përfshirjen dhe marrjen në konsideratë të mendimeve dhe propozimeve të studentëve. Kjo konstatohet edhe në takimin me studentëve gjatë vizitës së GVJ-së.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i Universitetit të Arteve - Takimi me Këshillin e Studentëve, Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Njësitë bazë, kanë komunikim dhe takime të vazhdueshme me studentët, për shkak të specifikës që ka institucioni. Në takimin e zhvilluar me studentët me GVJ-së, konstatohet se studentët ndihen të lirë dhe të hapur për të shprehur mendimin dhe dhënë kontributin e tyre në takimet, mbledhjet dhe aktivitetet artistike.</p> <p>Njësia bazë zhvillon pyetësor për mundësitë e përmirësimit të procesit mësimor dhe vlerësimit që studentët bëjnë për stafin akademik.</p> <p>Studentët janë pjesëmarrës edhe në mbledhjet e hapura në departament, në programet dhe aktivitete të ndryshme artistike që organizohen gjatë semestrit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i Universitetit të Arteve - Takimi me Këshillin e Studentëve, Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në rregulloren e programeve të studimit, cikli i dytë, Kreu 5, paraqet të kontrollin e dijeve, të cilat një të drejta të barabarta, pa asnjë ndarje, midis studentëve të këtij programi. Rregulloret e brendshme përcaktojnë edhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Më specifikisht kjo është detajuar edhe në syllabuset e secilës lëndë.</p> <p>Procesi i zhvillimit të sezonit të provimit, promovimi dhe kontrolli i dijeve, dokumenti i vlerësimit të studentit si dhe e drejta e përmirësimit të notave janë pjesë e rëndësishme në rregulloren e ciklit të dytë të studimit. Provimet janë të sekretuara dhe pas nxjerrjes së rezultateve, studentët kanë mundësinë të marrin sqarime nga pedagogët lidhur me procesin e vlerësimit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sekretimi i Provimeve, Rregullore mësimore e Ciklit të dytë të studimeve Master - Syllabuset e Planit Mësimor të Programit të Studimit Master I Arteve Klarinetë dhe Mësues.
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se, Universiteti i Arteve, përmbush plotësisht standartin V.5, për arsye se përfshin dhe angazhon studentët në organet</i></p>



	vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.		
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përbërshme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Gjatë vizitës së GVJ-së, në Universitetin e Arteve, konstatohet se ky institucion në shërbim të informimit të studentëve, por edhe përputhje me aktet ligjore dhe rregullatore të tij, gjendet zyra e Informimit të Studentëve, të Këshillimit dhe të Karrierës, dhe Alumni, e cila kategorizohet si njësi ndihmëse në funksion të institucionit.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në rregulloren e Universiteti të Arteve, Kreu 1, Neni 34, paraqet Komisionin e marrëdhënieve me studentët, i cili është ngritur për të garantuar dhe zhvilluar marrëdhëniet midis organeve drejtuese të institucionit dhe të studentëve apo organizmave studentore, që përmban edhe informimin rreth proceseve dhe çështjeve të ndryshme akademike/artistike që lidhet me studentët. Referencë: - Rregullore mësimore e Ciklit të dytë të studimeve Master, Kreu 1, Neni 34 - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në bashkëpunim me këshilluesit e karrierës së çdo njësie bazë dhe kryesore, në bashkëpunim me zyrën e informimit të studentëve, të këshillimit dhe karrierës, dhe Alumni, zhvillojnë takime dhe aktivitete për çështje të ndryshme në këtë fushë. Gjatë vizitës së GVJ-së në institucion dhe takimit me studentët, konstatohet se të gjithë studentët ishin të informuar, të familjarizuar dhe orientuar për çështje të ndryshme nga kjo zyrë. Gjithashtu, studentët ishin të orientuar të zhvillonin praktikat mësimore ose intervista pune, me orientimin e kësaj zyre dhe stafit akademik të njësisë bazë, në institucionet ku Universiteti i Arteve ka marrëveshje ose me zgjedhjet e tyre preferenciale. Referencë: - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Rregullore mësimore e Ciklit të dytë të studimeve Master - Urdhër Nr.100, dt.25.2.2022 Miratimi i Rregullores për Zhvillimin e praktikave profesionale të mësuesit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Ëeb site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

60

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në faqen zyrtare online të Universitetit të Arteve, gjendet një vend i veçantë për vazhdimësinë e kontaktit dhe ndjekjen e studentëve të diplomuar nga universiteti. Në faqen zyrtare, studentët e diplomuar, nëpërmjet regjistrimit në platformen GRADUA, studenti mund të formoje Cv-në dhe të publikojë profilin personal artistik, të çertifikuar nga universiteti. Studenti, nëpërmjet kësaj platforme, informohet mbi mundësitë e punës, praktikave profesionale.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqja zyrtare online e Universitetit të Arteve, Alumni, Gradua, http://www.uart.edu.al/index.php?page=faqe&id=705&niveli=71 								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se, Universiteti i Arteve, përmbush plotësisht standardin V.6, për arsye se posedon procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="2"></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="2"></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Universiteti i Arteve, nëpërmjet Statutit, Rregullores së Përgjithëshme, Rregullores së Ciklit të dytë të Studimeve dhe Planit Strategjik, ka paraqitur në mënyrë të detajuar dhe të qartë, mënyrën e zhvillimit të mësimdhënies me metodologji moderne dhe qasje artistike shkencore, sipas specifikës dhe statutit të veçantë që ky institucion gëzon. Konstatohet se gjatë vizitës në GVJ-së, në Universitetin e Arteve, mësimdhënia moderne shoqërohet edhe me strukturimin e ambienteve sipas kriterëve bashkëkohore dhe modern të ambienteve fizike. Përdorimi metodave të ndryshme bashkëkohore sipas moduleve të lëndëve specifike të programit (siç janë lëndët e instrumentit klarinetë), bashkojnë përvojën shumëvjeçare të institucionit me metodikat moderne të përfituara gjatë kualifikimit të stafit ndër vite.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: cc.ascal.al



61



	<p>Referenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte Klarinetë dhe Mësuesi - Rregullore e Universitetit të Arteve - Plani strategjik I Universitetit të Arteve, 2018-2025
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Njësia bazë, e cila së bashku me njësinë kryesore dhe në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, zhvillojnë monitorime dhe vlerësojnë aftësitë e mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmës akademik, nëpërmjet formularit të performancës. Duke mos cënuar lirinë akademike, monitorimi i stafit në ambientet fizike ku zhvillohen orët mësimore (duke marrë parasysh specifikat e lëndës), me kërkesën për përmirësim nga studentët, mund të vlerësohet nga një grup i ngritur nga njësia bazë.</p> <p>Një tjetër aspekt monitorimit të mësimdhënies akademike, është edhe ndërtimin e planit mësimore të lëndës, ku sipas rregullores së ciklit të dytë të studimeve, drejtuesi i lëndës harton programin e lëndës dhe më pas konsultohet me grupin përkatës mësimore të departamentit, me parimet themelore të shmangies së temave të përsëritura dhe njohurive paraprahe të nevojshme që duhet të ketë studenti për përvetësimin e programit përkatës.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Statuti i Universitetit të Arteve - Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte Klarinetë dhe Mësuesi
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Universiteti i Arteve, nëpërmjet Komisionit të përherëshëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, dhe zyrës mësimore, garanton hartimin e formularit të vlerësimit të metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe korrektesës së pedagogut, nga studentët. Nga të dhënat e këtij formulari, njësia bazë dhe kryesore vihet në dijeni dhe merren masa për vazhdimësinë procedurale sipas Statutit (për përgjegjësitë e stafit akademik, Përgjegjësinë disiplinore) dhe Rregulloren e Përgjithëshme. Statuti i Universitetit të Arteve, Evidenca I.I.1.2.1e paraqet qartë, të drejtën për studentëve për të shprehur opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të brendshëm (neni 124).</p> <p>Nga vizita e GVJ-së, zhvilluar në Universitetin e Arteve, nga takimi me studentët, kostatohet së studentët, jo vetëm nëpërmjet formati të vlerësimit</p>


	<p>periodik të stafit akademik, por edhe për çdo pakënaqësi që mund të kenë, ndihen të lirshëm ta diskutojnë me profesorin e lëndës ose në njësinë bazë.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte Klarinetë dhe Mësuesi - Statuti i Universitetit të Arteve 								
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Gjate vizitës së GVJ-së, në Universitetin e Arteve, konstatohet se, zyra mësimore pasi përpunon të dhënat e formularëve të vlerësimit nga studentët për pedagogët, vë në dijeni për rezultatet njësinë bazë dhe kryesore. Më pas, bashkë me Komisioni i përherëshëm për Sigurimin e Brednshëm të Cilësisë, marrin vendimin për problematika dhe vazhdimësinë e rprocedimit disiplinor (te cila është e qartë në Statutin e Universitetit të Arteve, neni 65)</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Statuti i Universitetit të Arteve 								
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti i Arteve, nëpërmjet strategjive të planit 2018-2025, Statutit dhe statusit të veçantë që gëzon, promovon shembuj të praktikave të mira artistike, si dhe nxit personelin akademik në rritjen e cilësisë, nëpërmjet dhënies së hapsirës për të marrë pjesë në aktivitet të ndryshme artistike, dhe zhvillimin e koncerteve të ndryshme, të cilat reflekton në mësimdhënien e tyre.</p> <p>Gjithashtu, praktikat e shkëmbimeve të stafit akademik, të ofruara nga projekte dhe marrëveshje të ndryshme, u jep mundësi atyre në përfitimin e përvojave të reja dhe të ndryshme, si dhe reflektimin e tyre gjatë mësimdhënies në këtë institucion.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani strategjik I Universitetit të Arteve, 2018-2025 - Marrëveshje, Faqja Zyrtare online, Universiteti I Arteve, http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=1089&niveli=95 - Statuti i Universitetit të Arteve - Projekte, Faqja zyrtare online, Universiteti i Arteve,, http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=784&niveli=156, 								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ vlereson se kriteri VI.1 përmbushet plotësisht, ku Universiteti i Arteve, ndjek politika të qarta për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Universiteti i Arteve, ka ndërtuar një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë bazuar në aktet rregullatore të aprovuara si “Statuti i Universitetit të Arteve”, “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”, në periudhën 2018-2025”,</p> <p>Universiteti i Arteve, nëpërmjet planit strategjik 2018-2025, paraqet strategjitë dhe politikat, paraqet synimet e zhvillimit, rezultatet e pritëshme, hapat strategjik si dhe veprimet për realizimin.</p> <p>Sigurimi i cilësisë mbetet kërkesë themelore e Universitetit të Arteve për rritjen e reputacionit brenda dhe jashtë vendit, duke u bazuar në aktet dhe nënaktet ligjore të arsimit të lartë (shiko statutin) “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në ILA, në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani strategjik i Universitetit të Arteve, 2018-2025 - Statuti i Universitetit të Arteve
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertëve të jashtëm.</p>	<p>Sipas Planit strategjik 2018-2025, zbatimi i strategjive së rritjes së cilësisë së brendshme, është e vazhdueshme për tu përgjigjur kërkesave të aktualitetit.</p> <p>Në zbatim të legjislacionit dhe bazës rregullatore të ndërtuar nga vetë Universiteti i Arteve, Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet); • Komisioni i Përherëshëm për sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, icila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikrat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit (ku përfshinë edhe studentët). <p>Konstatohet se gjatë vizitës së GVJ-së, në institucion, në plani zbatohet në dukje me diversitet modelesh, metodash etj, gjatë procesit të mësimdhënies, në formulimin e kurrikulave si dhe në aktivitetet e ndryshme me aspekt artistik. Për këtë promovohet mësimi e krijimtaria përmes angazhimit në punë praktike konkrete (praktika mësimore ose në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Ëëb site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>angazhime të ndryshme artistike siç mund të jepet shembulli i 60 ditë 60 koncerte) me qëllim arritjen e zhvillimit të vazhdueshëm profesional.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Plani strategjik i Universitetit të Arteve, 2018-2025 		
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve, mundëson realizimin e sigurimit të jashtëm të cilësisë në bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL.</p> <p>Universiteti i Arteve është akredituar institucionalisht për një afat 5 vjeçar sipas vendimit të Bordit të Akreditimit të ASCAL : Vendim BA Nr. 17, datë 24.03.2022 Për Akreditimin e UART.”</p> <p>Përveç akreditimit institucional, Universiteti i Arteve ka akredituar dhe është në proces akreditimi të programeve të ciklit të dytë të studimi, specifikiisht si programi Master i Arteve ‘Klarnetë dhe Mësuesi’.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendim BA Nr. 17, datë 24.03.2022 Për Akreditimin e UART.” 		
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Në palin strategjik 2018-2025, të Universitetit të Arteve, vizionin e tij e mbështet te strategjitë kryesore si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët politika e përzgjedhjes dhe inkurajimit të talenteve; • Programet, kurrikulat; • Stafin akademik-formimi dhe riformimi • Mbi bazën e këryre strategjive, Universiteti I arteve ka rritur vizionin e tij strategjik në tre boshte kryesore, sic janë • Edukimi • Krijimtaria artistike dhe kërkimi shkencor • Produkti artistik dhe menaxhimi I tij. <p>Për të realizuar objektivat dhe vizionin e universitetit, në planin strategjik është mirëpërdorur metodologjia e analizës së faktorëve të brendshëm (me pikat e forta dhe të dobëta), si dhe faktorët e jashtëm (me mundësitë dhe kërcënimet).</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani strategjik i Universitetit të Arteve, 2018-2025 		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.2 përmbushet plotësisht, sepse Universiteti i Arteve, harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të cilësisë..</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td style="background-color: black; color: white;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: black; color: white;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		


				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve, nëpërmjet planit strategjik të 2018-205, paraqet strategji dhe politika për përmirësimin e procesit akademik të programeve master, specifikisht Master i Arteve në 'Klarinetë dhe Mësuesi'.</p> <p>Edukimi në Universitetin e Arteve përmbush këto detyrime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimin e programeve të studimit; • Forcimin e orientimit drejt studentëve dhe tregut; • Zgjerimin e edukimit drejt specializimeve të gjera dhe zhvillimi i formave të reja të edukimit; • Sigurimin e infrastrukturës së mësimin dhe asaj organizative; • Forcimin e kompetencave akademike, profesionale, sociale dhe etike të edukimit (shiko Statutin). <p>Për të përmbushur këto detyrime, Universiteti i Arteve, në planin strategjik 2018-2025, ka analizaur pritshmëritë, vështirësit dhe pengesat, hapat strategjik dhe veprimet e marra.</p> <p>Nisur nga vizita e GVJ-së në këtë institucion, konstatohet se programet e studimit janë të mirëorganizuara, sipas akteve ligjore, me lëndët specifike modern të profesionit, orientimin e studentëve në tregun e punës nëpërmjet marrëveshjeve të realizuara në nivel institucional, si dhe në përfshirjen e studentëve në programe dhe koncerte të ndryshme artistike.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Plani strategjik I Universitetit të Arteve, 2018-2025 - Raporti Vjetor i Vetvlerësimit, Departamenti I Interpretimit, 2021-2022
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve, duke u bazuar edhe në specifikën e tij, vihen re instrumente të ndryshme në matjen e cilësisë dhe vlerësimit gjatë vitit akademik. Aktivitetet artistike, të cilat kanë marrë karakter akademik, vlerësohen nga specialistët e kësaj fushe, specifikisht, aktivitetet artistike dhe koncertet që vlerësohen prej artistëve akademik të punësuar në këtë institucion. Vlerësimet shpeshherë regjistrohen në format të shkruar.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Universitetin e Arteve, Zyra e këshillimit të studentëve, si dhe Komisioni i Sigutimit të Brendëshëm të Cilësisë, zhvillojnë takime dhe diskutime të shpeshta me studentët, për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së procesit mësimor. Një ndër këto diskutime, ishte nevoja për përmirësimin e kushteve të ambienteve dhe</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al





	<p>sallave për ushtrimin dhe praktikimin e instrumenteve, sidomos me ngrohjen, Këtë kërkesë të studentëve, njësitë kryesore e përcollën në hierarkinë e universitetit, ku përfundoi me rikonstruktiv të godinës dhe me plotësimin e kërkesës së studentëve.</p> <p>Dokumentet e përcjellë përfshijnë edhe komunikimet midis zyrave për transmetimin e informacionit të mbledhur nga komisioni i sigurimit të cilësisë KSBC drejt rektoratit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Statuti i Universitetit të Arteve
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet 67ocale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Si garantues i cilësisë është kryesore njësi bazë, me përgjegjësin e departamentit për vlerësimin e secilit pedagog të lëndëve. Në "formular për vlerësimin e pedagogut nga eprori-kolegu" jepen disa kritere që vlerësohen sipas renditjes nga shumë mirë, mirë, pjesërisht dhe dobët. Nëpërmjet këtij formulari, vlerësohet organizimi dhe qartësia, si edhe komunikimi me studentët.</p> <p>Ndërsa nëpërmjet formularit që studentët vlerësojnë pedagogun, përpara sezonit të provimeve (për të mos pasur konflikt interesi), maten elementët e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimet objektive të profesorit ndaj studentit, komunikimi, entuziazmi, mënyra e përdorimit të referencave bashkëkohore dhe të dobishme për studentët, zotërimin e njohurive dhe përdorimin e tyre me efikasitet në auditor etj.</p> <p>Gjithashtu, nga vizita e GVJ-së në Universitetin e Arteve, konstatohet se, praktikat akademike të përdorura për përgatitjen e studentëve, mundëson aftësinë e studentëve për të qenë instrumentist dhe mësues në tregun e punës në Shqipëri. Kjo dallohet qartë të informacionet e Alumni, ku të diplomuarit nga programet e ciklit të dytë, në fakultetin e muzikës, të gjithë janë të punësuar brenda dhe jashtë Shqipërisë.</p> <p>Disa prej Studentëve të Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi', të cilët kishin qenë pjesë e shkëmbimeve studentore, shprehën se cilësia e mësimdhënies, kontrolli dhe vlerësimi i përhershëm i dijeve në këtë institucion, u kishte dhënë mundësinë të ndiheshin më të përgatitur se studentët e universiteteve pritëse perëndimore. Kjo tregon arritjen dhe cilësinë në përgatitjen së studentëve.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Studentët, Faqja zyrtare online, Universiteti I Arteve, http://www.uart.edu.al/index.php?page=faqe&id=9&niveli=66 - Formulari për vlerësimin e pedagogut, NJCBS
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e</p>	<p>Universiteti i Arteve, vlerëson veprimtarinë akademike për cilësinë e saj nëpërmjet pyetësorëve me studentët për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Marrja e vlerësimeve nga studentët realizohet përmes:</p>

<p>instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfituara nga ky program.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Pyetësotreve me studentët e programit të studimit; • Pyetësorëve rreth vlerësimin të didaktikës dhe kurikulës; • Si dhe intervista në formë bisedash midis stafit përgjegjës (në pjesën më të madhe shefit të departamentit). <p>Rezultatet përdoren nga drejtuesit e departamenteve i cili njofton edhe dekanatin për të reflektuar në vlerësimin e performancës së çdo pedagog, për marrjen e masave për përmirësimin e mësimdhënies ose për probleme të ndryshme me komunikimin .</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Formulari për vlerësimin e pedagogut, NJCBS - Arkiva, Zyra e BNJ dhe Informacion/Protokoll/Arkivë 						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në gjetjet dhe arkivat e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.3 përmbushet plotësisht, ku Universiteti i Arteve, monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëni.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="531 869 922 947"></td> <td data-bbox="922 869 1114 947">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1114 869 1324 947">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td data-bbox="531 947 922 985"></td> <td data-bbox="922 947 1114 985"></td> <td data-bbox="1114 947 1324 985">X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti i Artit, nëpërmjet Komisionit të përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, ofron mundësinë për garantimin e cilësisë së tij dhe programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga pesë anëtarë, nga një përfaqësues nga secili fakultet (personel akademik me kohë të plotë), një përfaqësues specialist i NJSBC-së dhe një përfaqësues nga studentët. Në rastet kur Universiteti i Arteve i nënshtrohet procesit të vlerësimin në kuadër të akreditimit institucional ose për programet e studimit, mund të thirret edhe një ekspert i jashtëm. Gjatë vizitës së RVJ-së në institucion, konstatohet se ky komision ka funksionuar për të mundësuar vazhdimësinë e cilësisë së institucionit dhe programeve të hartimit (nëpërmjet orientimit të stafit për realizimin e dokumentacionit të plotë të akreditimit dhe trajnimit të stafit, me anë të takimeve, për vazhdimësinë e procesit).</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve

	<ul style="list-style-type: none"> - Shqyrtimi i dokumentacioneve të publikuar në ASCAL, në llogaritë e ekspertëve
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Universiteti i Arteve, përcakton organizimin dhe funksionimin, si dhe detyrat konkrete dhe përgjegjësitë e çdo anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në Statut dhe në Rregullore.</p> <p>Ndërkohë në garantimin e sigurimit të cilësisë së brendshme, dhe cilësisë e mbarëvajtjes së programeve të studimit në ciklin e parë dhe të dytë, specifikisht në Master i Arteve 'Klarnetë dhe Mësuesi', një rol shumë të rëndësishëm luajnë edhe njësi të tjera (siç janë departamenti, kordinatori i programit, sekretaria mësimore etj), të Universitetit të Arteve.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i Universitetit të Arteve - Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte Klarnetë dhe Mësuesi - Rregullore e Universitetit të Arteve
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në planin strategjik 2018-2025 të Universitetit të Arteve, në kapitullin për Sigurimin e Cilësisë, shprehet se ka si synim të zhvillojë një sistemi të gjerë e me dobishmëri të sigurimit të cilësisë, duhet të përfshihen të gjithë aktorët: shteti, pedagogët studentët dhe strukturat ndihmëse. Synimi i zhvillimit të sistemit të sigurimit të cilësisë në Universitetin e Arteve përfshin hartimin e politikave, procedurave, kulturës për sigurimin e cilësisë, duke e krahasuar me standardet e vendosura. Synim i veçantë në sigurimin e cilësisë në Universitetin e Arteve është sistemi i vetëvlerësimit, mbikëqyrjes dhe akreditimit, duke respektuar autonominë. Nga vizita në institucion e RVJ-së konstatohet se në këtë komision ishin përfshirë edhe një anëtarë nga sekretaria mësimore dhe një nga Zyra e Këshillimit të Karrierës. Kjo konstaton se një pjesë e synimeve po zhvillohen për të arritur rezultatet e pritëshme për periudhën 2018-2025 të planit strategjik.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Plani strategjik I Universitetit të Arteve, 2018-2025
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në statutin e Universitetit të Arteve, ku anëtarëve të komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, zgjidhen nga Senati Akademik për një mandatë dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ky proces parandalon diskriminimet ose pabarazitë, si dhe mundëson integritet të gjithë pjesëtarëve të tjerë që plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e këtij grupi.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i Universitetit të Arteve





<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në statut përcaktohet se, në raste të ndryshme, sipas nevojave të institucionit për rritjen dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, mund të rekrutohet një ekspert i jashtëm.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Universitetin e Arteve, konstatohet se institucioni nuk e ka patur të nevojshme rekrutimin e një eksperti të jashtëm, por nëpërmjet projekteve të ndryshme siç është 'Capacity building' ose ERASMUS+ ka pasur konsulencë të vazhdueshme me profesorë të universiteteve të ndryshme ndërkombëtare perëndimore të njohur në fushën e artit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Statuti i Universitetit të Arteve - Projekte, Faqja zyrtare online, Universiteti i Arteve, http://www.uart.edu.al/index.php?page=faqe&id=784&niveli=156 						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në gjetjet dhe arkivat e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.4 përmbushet plotësisht, ku Universiteti i Arteve përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra.</i></p>						
<p>Shikalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="531 913 930 981"></th> <th data-bbox="938 913 1114 981">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1121 913 1315 981">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="531 981 930 1023"></td> <td data-bbox="938 981 1114 1023"></td> <td data-bbox="1121 981 1315 1023">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Universiteti i Arteve, me Komisionin e përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë hartojnë planin për aktivitetet, qëllimet, arritjet etj në planin strategjik 2018-2025.</p> <p>Baza rregullatore që ka hartuar Universiteti i Arteve për sigurimin e brendshëm të cilësisë përfshin ndër të tjera edhe këto dokumente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; ▪ Statuti; ▪ Rregullorja e institucionit. <p>Një pjesë e dokumentacioni është publike siç janë statuti, rregulloret dhe veprimtaritë, ku të gjithë studentët mund ta marrin nga zyra mësimore.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe</p>	<p>Universiteti i Arteve, proceduron mbi ruajtjen e të dhënave të autorit, duke qenë sensitive, për shkak edhe të profilit specifik që gëzon. Për këtë arsye, konstatohet se të dhënat e monitorimit të Komisionit të Përherëshëm për Sigurinë e Brendshme të Cilësisë së Universitetit të Arteve, nuk</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Është site: www.ascal.al



70



<p>legjislaconin për të dhënat personale.</p>	<p>publikohen. Informacioni nga monitorimi i njësive të ndryshme, shkon te rektorati, veçanërisht te zëvendës rektori për çështjet mësimore, dekanët dhe shefat e departamenteve (duhet të rikujtohet se në këtë institucion egziston edhe komunikim i shpejt joformal, për zgjidhjen sa më shpejt të problemeve).</p> <p>Gjatë vizitës të GVJ-së, në dosjet e personelit akademik, gjendeshin dokumentacione të plota të detajuara, përfshirë edhe vlerësimi më i fundit i stafit i përfshirë në dosje.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani strategjik i Universitetit të Arteve, 2018-2025 - Statuti i Universitetit të Arteve - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësi të evidentuara.</p>	<p>Gjatë vizitës së RVJ-së në Universitetin e Arteve konstatohet se rezultatet nga anketimet diskutohen në njësinë bazë dhe kryesore për të nxjerrë një plan masash veprimi për ndryshimin e pikave që mund të jenë të dobëta. Të dhënat nga pyetësorët vetë-vlerësues shfrytëzohen edhe për të bërë krahasime në periudha kohore si dhe për të bërë vlerësim të performacës.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e RVJ-së në Universitetin e Arteve, konstatohet se sigurimi i cilësisë bazohet në disa rrathe të kontrollit dhe disa nivele të zhvillimit siç janë kontrolli nga drejtuesit e departamentit, përgjegjësi i grup lëndëve, kordinatori i programit, Komisioni i Përherëshëm i Sigurimit të brendshëm të Cilësisë si dhe Zyra e Kurrikulave.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Statuti i Universitetit të Arteve
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve, nëpërmjet bashkëpunimit me projektet e ndryshme te Erasmus +, Ersamus+ KA2, MERITA, etj, u jep mundësinë stafit akademik, administrative dhe studentëve të ndjekin trajnime, workshop, leksione të hapura, masterclass etj. Të cilësisë me standarte ndërkombëtare.</p> <p>Gjatë vizitës së RVJ-së në institucion vihet re se Komisioni i përherëshëm për Sigurinë e Cilësisë së Brendëshme, mundëson orientime për përmirësimin e sigurisë, specifikisht për programet e studimit të nivelit të dytë, përpara procesit të akreditimit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita e GVJ-së, në Universitetin e Arteve - Statuti i Universitetit të Arteve - Projekte, Faqja zyrtare online, Universiteti i Arteve, http://www.uart.edu.al/index.php?page=faqe&id=784&niveli=156

Konkluzione	<i>Bazuar në gjetjet dhe arkivat e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri V.5 përmbushet plotësisht, ku Universiteti i Arteve ku nëpërmjet politikave, proceseve dhe veprimtarive për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Master i Arteve 'Klarinetë dhe Mësuesi' janë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëeb site: www.ascal.al




Handwritten signature 72

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Ambjentet fizike të Universitetit të Arteve janë bashkëkohore, të rikonstruara dhe të përshatshme për realizimin e misionit të tij.
2. Konfirmojmë se Programi i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” është hartuar sipas kërkesave ligjore në fuqi dhe mund të ndiqet vetëm në Fakultetin e Muzikës pranë Universitetit të Arteve në Tiranë.
3. Programi i studimit Master i Arteve në “Klarinetë dhe Mësuesi” i formon profesionalisht studentët klarinetistë veçanërisht nga ana artistike dhe kulturore, por edhe nga ana pedagogjike përsa i përket ushtrimit të tyre në të ardhmen të profesionit të mësuesit në arsimin parauniversitar.
4. Departamenti i Interpretimit, ka numër të vogël të studentëve në programet që ofron. Kjo mundëson garantimin e cilësisë, dhe ndërveprimin pedagog-student, në mënyrë më cilësore.
5. Qendra e ngritur për komunikimin zyrtar të departamenteve, ndërmjetëson komunikim efektiv, të shpejt dhe realizon bashkëpunimin e shumë vepritarive akademike dhe artistike.
6. Komunikimi zyrtar dhe shoqëror i stafit akademik dhe administrative, e cila reflekton me harmonizimin, frymën bashkëpunuese dhe pozitive midis tyre.
7. Universiteti I Arteve, nëpërmjet Fakultetit të Muzikës, Departamentit i Interpretimit, ka një kurrikulum të pasur të aktiviteteve artistike, me përfshirjen e gjithë stafit akademik.
8. Fakulteti I Muzikës zotëron qarkullimin e informacionit dhe informon stafin dhe studentëve nëpërmjet faqes zyrtare online.
9. Biblioteka e UART është e vetmja bibliotekë arti në Shqipëri, e cila me fondin e saj shkencor, muzikor, artistik dhe historik, ofron për studentët klarinetistë një katalog shumë të pasur me vepra të kompozitorëve shqiptarë dhe të huaj. Pasurimi i kësaj biblioteke me Katalogun e Shtëpisë së famshme gjermane Henle Verlag ofron për studentët e Fakultetit të Muzikës dhe veçanërisht të studentëve klarinetistë një mbështetje të madhe nëpërmjet opusit të veprave për klarinetë solo, muzikë dhome, në ansambël, si dhe parte orkestrale.
10. Promovimi i fuqishëm i studentëve klarinetistë bëhej nga vetë Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit dhe realizohej nëpërmjet daljes në skenë dhe performimit të studentëve përkrah pedagogëve të tyre në koncerte të ndryshme.



Pika të dobta


1. Pamjaftueshmëria e buxhetit, pengon motivimin maksimal të stafit akademik dhe administrative (Standardi II Kriteri 6).
2. Duhet të ketë më tepër trajnime për metodat e avancuara të mësimdhënies për personelin akademik.(Standardi III.1 kriteri 3)

Rekomandime

1. GVJ rekomandon se në sylabuse të bëhet formatizimi i njëjtë për të gjitha si dhe të vendosen rezultatet e mësimdhënies, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti.
2. GVJ rekomandon që sistemi antiplagjiaturë të rifunksionalizohet.
3. GVJ rekomandon që nstitucioni të nxit personelin akademik krijues/kompozitorët të krijojnë vepra solistike enkas për programin e studimit.
4. GVJ rekomandon që komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të ngrihet si zyrë përkatëse më vete.
5. GVJ rekomandon që në nivel fakulteti dhe Departamenti të Muzikës dhe Instrumenteve të hartohet një strategji afatmesme (me objektiva të matshëm dhe veprimtari konkrete dhe të buxhetuar nga institucioni) për një bashkëpunim dhe bashkërendim më të efektshëm me shkollat artistike (9-vjeçare dhe të mesme), por dhe shkolla të mesme të llojeve të tjera, lidhur me:

a-Mbështetjen e nxënësve që studiojnë klarinetë në shkollat e artistike për të rritur numrin e tyre

b-lidhjen me shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të tjera për identifikimin e taleneteve në fushën e instrumentit klarinetë, por dhe për intrumente të tjera, muzikore.



Strengths and affirmations

1. The physical facilities of the University of Arts are contemporary, reconstructed, and suitable to complete its mission.
2. Experts confirm that the study program 'Master of Arts' in "Clarinets and Teacher" has been designed according to the legal requirements in force and is offered just by the Faculty of Music at the University of Arts in Tirana.
3. The study program 'Master of Arts' in "Clarinets and Teacher" professionally trains clarinet students, especially from the artistic and cultural background, but also from the pedagogical perspective, in terms of their future exercise of the teaching profession in pre-university education.
4. The Department of Interpretation has a small number of students in the programs it offers. This enables quality assurance, and professors-student interactions are more qualitative.
5. The center established for the official communication of the departments mediates effective, fast communication and realizes the cooperation of many academic and artistic activities.
6. Official and social communication of the academic and administrative staff reflects their harmony, cooperation, and positive spirit.
7. The University of Arts, through the Faculty of Music, Department of Interpretation, has a rich curriculum of artistic activities, with the involvement of all academic staff.
8. The Faculty of Music owns the circulation of information and informs the staff and students through the official website.
9. The library of the University of Arts, is the only art library in Albania with its scientific, musical, artistic, and historical fund, offering clarinet students a rich catalog of works by Albanian and foreign composers. The enrichment of this library with the Catalog of the famous German House Henle Verlag offers to the students of the Faculty of Music and especially the clarinetist students great support through the opus of works for solo clarinet, chamber music, in the ensemble, as well as orchestral parts.
10. The strong promotion of clarinet students was done by the Faculty of Music and the Department of Interpretation and was realized by the appearance on stage and the performance of the students alongside their professors in various concerts.


Weaknesses

1. The insufficiency of the budget prevents the maximum motivation of the academic and administrative staff (Standard II, Criteria 6).
2. Must be more training for advanced teaching methods to academic staff (Standard III.1, Criteria 3).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Recommendation


1. Experts recommend that all syllabi should be unified, as well as setting the teaching results, competencies, and skills that the student acquires.
2. Experts recommend that the anti-plagiarism system should be re-functionalized.
3. Experts recommend that the institution encourages creative academic staff/composers to create solo works specifically for the study program.
4. Experts recommend that the Internal Quality Assurance Commission be set up as a separate office.
5. Experts recommend that at the faculty and department level, a medium-term strategy (with measurable objectives and concrete activities budgeted by the institution) be drawn up for more effective cooperation and coordination with artistic schools (9-year and high school), but also high schools of other types, related to:
 - a-Supporting students studying clarinet in artistic schools to increase their number;*
 - b- The connection with 9-year and other secondary schools for the identification of talents in the field of the clarinet instrument, but also for other musical instruments.*



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Ëeb site: www.asca.al

E-mail: info@asca.al

